

UNIVERZITETI I EJL

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ

SEE UNIVERSITY



Fakulteti i Juridik

Pravnion Fakultet

Law Faculty

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

PROGRAMI-E DREJTA CIVILE

TEZA:

” KONTRATAT MARTESORE DOMOSDOSHMËRI APO REALITET”

Kandidati:

Arbesa Zenuni

Mentori:

Doc.D-r Emine Zendeli

Tetovë, 2018

Familjes time!

*Disa nga kontratat mes njerëzve gdhenden në dërrasa, të tjera në rrasa guri, por
kontratat martesore sanksionohen nga fëmijët.*

Pitagora

❖ **MIRËNJOHJE**

Nëpërmjet këtij studimi m'u dha mundësia të shoh nga afër realitetin e martesës dhe kontratës martesore. Realizimi i këtij punimi master ka qenë një përpjekje e gjatë dhe shumë e vështirë, por finalizimi i tillë nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e vazhdueshme, këshillat, sugjerimet shkencore të profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë, drejtimin Juridiko-Civil, miqtë dhe familjarët e mi. Falenderimi i parë shkon për udhëheqësen time, *Prof.Dr Emine Zendeli* pa këshillat, vërejtjet, sugjerimet dhe inkurajimet e saj ky punim nuk do të ishte finalizuar sot. Në fund mbi të gjithë jam thellësishtë mirënjohëse familjës sime, për besimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë për mua. Mbështetja e vazhdueshme shpirtërore, morale dhe financiare e prindërve më ka dhënë forcën dhe motivin e nevojshëm për të finalizuar këtë punim dhe për të ecur përpara në jetë. Pa ta asgjë nuk do të kishte qenë e mundur.

Prindërve të mi!

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| ❖ MIRËNJOHJE | 4 |
| ❖ HYRJE | 7 |
| KAPITULLI I PARË | 9 |
| 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KONTRATËN MARTESORE | 9 |
| 1.2 TË DREJTAT PASURORE DHE PASURIA E VEÇANTË E BASHKËSHORTËVE | 27 |
| 1.3 NDARJA E PASURISË SË PËRBASHKËT | 30 |
| 1.3.1 NDRYSHIMI I REGJIMIT PASUROR MARTESOR | 31 |
| 1.4 AUTONOMIA E VULLNETIT NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE PASURORE | 35 |
| KAPITULLI I DYTË | 38 |
| 2. ROLI DHE RËNDËSIA E KONTRATËS MARTESORE | 38 |
| 2.1 DOMOSDOSH MËRIA E KONTRATËS MARTESORE | 39 |
| 2.2 PASURIA MES BASHKËSHORTËVE SIPAS RREGJIMIT PASUROR NË BASHKËSI | 40 |
| a) Regjimi pasuror ligjor – bashkësia e pasurisë së krijuar në martesë | 46 |
| 2.3 ADMINISTRIMI I PËRBASHKËT | 47 |
| KAPITULLI I TRETË | 50 |
| 3.1 LËNDA E HULUMTIMIT | 50 |
| 3.2 QËLLIMET E HULUMTIMIT | 51 |
| 3.3 HIPOTEZAT | 52 |
| 3.4 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT | 52 |
| 3.5 RËNDËSIA E PUNIMIT | 54 |
| 3.6 ASPEKTE KRAHASUESE | 55 |
| 3.6.1 REGJIMI PASUROR I BASHKËSHORTËVE NË KORNIZËN NORMATIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË | 55 |
| 3.7 BASHKËSIA ME KONTRATË SIPAS KODIT TË FAMILJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | 57 |
| 3.8 KONTRATA MARTESORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | 58 |
| 3.9 KOMPACION NË MES KODIT FAMILJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE LIGJIT TË FAMILJES MAQEDONISË | 59 |
| 3.10 REGJIMI PASUROR MARTESOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS | 61 |
| KAPITULLI I KATËRT | 66 |
| 4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME | 66 |

| | |
|------------------------------------|----|
| 4.1 Literatura e shfrytëzuar | 69 |
| 4.2 Ligje dhe vendime..... | 71 |

❖ HYRJE

Martesa është një ndër institucionet e lashta, e gjithësi një ndër fenomenet më të rëndësishme shoqërore dhe juridike, është një lidhje midis një burri e një gruaje që kanë zotësinë e veprimit. Martesa si një bashkësi ligjore mbështet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok. Atë që ka krijuar dhe ka lidhur Zoti askush nuk mund të ndajë, mirëpo jeta mund të na përballon me sfida të cilat martesa e lidhur nuk mund ti'u rrezistojë dhe ashtu vij deri tek ndarja. Në këtë studim do të përpiqem që të shpjegoj rëndësinë e kontratës martesore për bashkëshortët në të drejtën familjare dhe jo vetëm këtë, poashtu do të analizoj normat ligjore të kontrates martesore në të drejtën familjare, rastet e cënimit në rast të shkurorizimit, të drejtat e bashkëshortëve që të kërkojnë të drejtat e tyre që janë të parapara me kontratën martesore. Në kontekst të përcaktimit të fatit juridik të kësaj pjese të garantuar me ligj në mënyrë të detajuar do të analizoj normat ligjore të shteteve të huaja dhe krahasimin e tyre me vendin tonë. Shkurorëzimi është një çështje shumë serioze. Është pika kulminante që arrin në konkluzionin se u ndërmor një vendim i gabuar me atë martesë. Një pjesë e madhe e jetës kaloi e mbushur me dhimbje, duke mos përmendur këtu ndonjë shkatërrim të mundshëm financiar.¹

E drejta familjare është një ndër fushat më të veçanta të së drejtës Private. Sipas dispozitave të Ligjit të Familjes bashkëshortët kanë mundësi që të parashikojnë një kontratë regjimit pasuror. Forma e aktit noterial është kusht për vlefshmërinë e kontratës martesore jo vetëm kur kontrata lidhet para lidhjes së martesës, por edhe kur ajo lidhet pas lidhjes së martesës.

Kontrata martesore duhet të regjistrohet në regjistrin e martesave ku figuron akti i martesës, i cili hartohet dhe administrohet nga shërbimi i gjëndjes civile. Sipas Legjislacionit Shqipëtarë (Kodi për Familje) kontrata e tillë duhet të regjistrohet edhe në regjistrin tregtar në rast se ajo përfshin ndryshime në drejtim të veprimtarisë tregtare të njerit apo të dy bashkëshortëve. Sanksioni që do të vuajnë bashkëshortët në rast se kjo kontratë nuk është regjistruar është mos respektimi i kontratës martesore nga të tretët.

¹ Çapo, Axhem “Njohuri enciklopedike nga misteret e botës I”, Shtypshk. Geer, Tiranë 2006, fq. 131.

Sipas Gjykatës Europiane të Drejtësisë² regjimi pasuror martesor përfshin jo vetëm regjimin pasuror në kuptimin e ngushtë të tij, por përfshin gjithashtu të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve që rrjedhin nga martesë ose nga zgjidhja e saj (vendimet/masat e përkohshme dhe definitive të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës). Regjimi i bashkësisë së pasurive të përcaktuar në Ligjin për Familjen, konsiderohet si regjimi më i përshtatshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, si regjimi pasuror, që garanton barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve gjatë martesës.

² Vendim i GJED C-143/78, 17 Mars 1979 “*Jacques de Cavel vs Louise de Cavel*”

KAPITULLI I PARË

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KONTRATËN MARTESORE

Martesa përfaqëson një bashkim juridik ndërmjet dy personave të gjinive të ndryshme, të cilët synojnë një jetesë të përbashkët si edhe realizimin e interesave personale dhe pasurore, duke formuar kështu një bashkësi në drejtim të kontributit dhe mbarëvajtjes së familjes.³

Në tërësinë e marrëdhënieve që lindin mes bashkëshortëve si rezultat i lidhjes së martesës, një rëndësi të veçantë paraqesin marrëdhëniet pasurore. Gjatë jetesës së përbashkët, bashkëshortët fitojnë të ardhura ose mund të bëhen titullarë të të mirave pasurore, të ardhura dhe pasuri të cilat në raportet bashkëshortore i nënshtrohen regjimeve specifike pasurore në raport me format e tjera të bashkëpronësisë. Martesa si një bashkëjetesë ligjore, mbështet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok si baza e unitetit në familje. Marrëdhëniet martesore të bashkëshortëve si pjesë esenciale e marrëdhënieve bashkëshortore kanë egzistuar edhe në të kaluarën prandaj duhet të shikohen dhe si kategori historike, në këtë kontekst edhe regjimi juridik i tyre, në sisteme të ndryshme ka njohur modele të ndryshme. Në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore ato madje kanë ndikuar edhe në krijimin e marrëdhënieve pasurore të pabarabarta ndërmjet bashkëshortëve, respektivisht më së shpeshti në krijimin e pozitës së pabarabartë ekonomike të gruas në martesë. Aktualiteti i regjimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në sistemet juridike lidhet me nevojën e realizimit të të drejtave dhe detyrave të bashkëshortëve në martesë.

Nëpëmjet kontratës martesore bashkëshortët organizojnë mjetet ekonomike të familjes së tyre, përcaktojnë midis pasurive ato që do të jetë në pronësi tërësore të njërit prej tyre dhe të atyre që do të jenë të përbashkëta. Kontrata martesore është konsideruar si një instrument ndihmës që lejon palët të zgjedhin midis modeleve me kriteret e parashikuara me ligj dhe me interes të familjes. Pavlefshmëria e kontratës së martesës nuk sjell pasoja mbi martesën. Në këtë rast bashkëshortët i nënshtrohen regjimit martesor ligjor. Kontrata e martesës është shkruar dhe bëhet para noterit. Kontratat është e nevojshme të jetë e shkruar jo vetëm për provë, por edhe për vlefshmëri të marrëveshjes martesore.

³ Omari Sonila, *E drejta familjare*, botimet, Morava, Tiranë 2012, fq.36

Kontrata e martesës është komplekse në radhë të parë nga përmbajtja e saj. Sigurisht ajo ka për qëllim para se gjithash të përcaktojë statusin familjar dhe financiar të familjes dhe ekonomisë së ardhshme, lirinë e bashkëshortëve për tu referuar njërit nga modelet që Kodi i Familjes vendos në dispozicion të tyre, madje ndërtimin e saj në të gjitha pjesët. Në një kontratë martesore mund të parashikohen edhe çështje të cilat nuk janë parakushte pasurore, tani mund ti kemi edhe dispozitat me status; njohja e një fëmijë që ka lindur jashta martesë. Ky regjim është i ndërmjetësim midis pasurisë së ndarë dhe bashkësisë.⁴ Në të kaluarën kontrata martesore kanë qenë shumë më e zakonshme ndërmjet bashkëshortëve në krahasim me ditët tona.⁵

Kontestet e natyrës pasurore ndërmjet (ish) bashkëshortëve për ndarjen e pasurisë së përbashkët janë konteste të ndërlikuara dhe mjaft të ndjeshme. Andaj, me lidhjen e kësaj kontrate thjeshtohet bukur shumë puna e gjykatës por edhe e palëve të mundshme gjyqësore, ngase ajo që duhet të vërtetohet në procedurë gjyqësore, tanimë veç është e rregulluar me kontratë. Në këto raste në mënyrë të plotë zbatohen dispozitat e kontratës mbi mënyrën e ndarjes së pasurisë së përbashkët. Kështu pra, në mënyrë më të mirë dhe më të plotë janë rregulluar marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, ndërsa mbrojtja juridike e bashkëshortëve në procedurë gjyqësore është bërë më e shpejtë dhe më efikase.⁶

Bashkëshortët (e ardhshëm) të cilët vendosin që të lidhin kontratë martesore duhet të kenë parasysh rrethanat vijuese: (sipas Ligjit për Familje të Republikës së Kosovës, Ligji Nr.24/32).

- ✓ *Kontrata martesore mund të lidhet para dhe gjatë martesës;*
- ✓ *Me këtë kontratë rregullohet pasuria aktuale e bashkëshort-ëve apo pasuria të cilën ata mund ta fitojnë në të ardhmen;*
- ✓ *Kontrata martesore duhet ta ketë formën e shkruar;*
- ✓ *Kontrata martesore duhet t'i përmbajë palët kontraktuese me të gjitha shënimet për identifikimin e tyre (emrat, adresat etj) në mënyrë që të prodhojë efekte juridike, kjo kontratë duhet të vërtetohet nga ana e gjykatës kompetente (komunale);*

⁴Ouari Sonila, *E drejta familjare*, botimet, Morava, Tiranë 2012, fq.37

⁵Scherpe, *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, fq.444

⁶Shala Afrim, Mr.sc Albert Zogaj, *Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsim Ligjor*, Justica, Viti I/2009. Numri 1/2009, fq.105

- ✓ *Procedura për vërtetimin e kësaj kontrate fillohet në atë mënyrë që pranë zyrës për pranimin e shkresave të gjykatës kompetente dorëzohet propozimi për vërtetimin e përmbajtjes së kontratës martesore, të cilës i bashkëngjitet edhe kopja e tekstit të kontratës;*
- ✓ *Referenti në zyrën e pranimit e pranon propozimin, e protokollon atë në protokollin përkatës, pas së cilës kjo lëndë e merr numrin e veçantë;*
- ✓ *Me ftesë të gjykatës, bashkëshortët duhet të paraqiten para gjykatës, me ç'rast gjyqtari përkatës, pasi që bën identifikimin e palëve, në prezencë të një dëshmitari bënë leximin e kontratës, duke i njoftuar palët (kontraktuese) bashkëshortore se me nënshkrimin e kësaj kontrate përjashtohet regjimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore;⁷*

Kontrata martesore në krahasim me kontratat tjera është shumë komplekse dhe një gjë e tillë nuk limitohet në përcaktimin e së drejtave dhe të detyrimeve midis një çifti bashkëshortor. E veçanta e rregullimit të saj mban një tërësi rrethanash. Kontrata e martesës është komplekse në radhë të parë nga përmbajtja e saj. Sigurisht ajo ka për qëllim para se gjithash të përcaktojë statusin financiar të ekonomisë së ardhme të familjes, lirinë e bashkëshortëve për t'iu referuar njërit nga modelet që Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë vendos në dsipozicion të tyre, madje ndërtimin e saj në të gjitha pjesët. Por, në kontratën martesore mund të parashikohen edhe kushte të tjera të cilat në nuk mund ti parashikojmë.⁸

Në radhë të parë, objekti i së drejtës martesore (si nëndegë e së drejtës familjare) përbëhet nga marrëdhëniet e natyrës personale. Këto janë marrëdhënie të cilat janë të rregulluara me norma ligjore imperative, si p.sh. kushtet për lidhjen e martesës, shkaqet e pavlefshmërisë së martesës, të drejtat dhe detyrat e çiftit bashkëshortor, shkaqet e pushimit ose të zgjidhjes së martesës, etj. Pa dyshim se marrëdhëniet personale martesore janë parësore. Por objekt i të drejtës martesore janë edhe marrëdhëniet e pasurore të cilat rrjedhin nga martesë. Marrëdhëniet pasurore kanë prejardhje nga marrëdhëniet personale prandaj edhe konsiderohen si dytësore.

⁷ Shala Afrim, Albert Zogaj, *Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsim Ligjor*, Justica, Viti I/2009. Numri 1/2009, fq.105

⁸ Arta Mandro – Bilalli, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, fq.321

Edhe këto marrëdhënie janë të rregulluara me ligj dhe janë në funksion të realizimit më të mirë të marrëdhënieve personale. Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjim pasuror martesor. Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme historiko-juridike dhe atyre juridiko-krahasuese, tregojnë se në periudha të ndryshme të zhvillimit shoqëror kanë ekzistuar regjime të ndryshme pasuroro-martesore. Ky regjim në masë të madhe ka qenë i kushtëzuar nga pozita të cilën e ka pasur gruaja në shoqëri. Sidoqoftë, shikuar në përgjithësi, ekzistojnë tri lloje të regjimit pasuror martesor: *regjimi i pasurisë së përbashkët, ai i pasurisë së veçantë dhe regjimi i pasurisë së përzier.*

Në bazë të zgjidhjeve ligjore të cilat janë paraparë në disa shtete të regjionit (Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Mal i Zi, Vojvodinë, etj.) e të cilat zgjidhje me disa specifika i ka paraparë edhe Ligji mbi Familjen i Kosovës (2004), regjimi i pasurisë së përbashkët martesore nuk është më regjim i detyrueshëm ligjor, ngase tani, çiftit bashkëshortor i është mundësuar që në bazë të dëshirës dhe nevojave të tyre ti rregullojnë edhe marrëdhëniet e tyre pasurore, thjeshtë duke lidhur kontratë. Historikisht, mënyra e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të çiftit bashkëshortor ka evoluar nga kalimi i pasurisë së gruas në pasurinë e burrit, pastaj në ndarjen e pasurisë së gruas me të cilën ka qeverisur burri, e deri te pasuria e përbashkët e bashkëshortëve. Sipas Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë (neni 6), martesë përkufizohet si bashkësi jetësore e përcaktuar me ligj në mes të një buri dhe gruaje në të cilën realizohet interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.⁹

E drejta martesore është një përmbledhje normash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet martesore. Normat juridike me të cilat rregullohet martesë dhe marrëdhëniet martesore janë kryesisht të natyrës urdhëruese. Me normat të natyrës urdhëruese rregullohet forma e lidhjes së martesës, marrëdhëniet pasurore juridike zgjedhja e martesës, si dhe edhe marrëdhënie të tjera të rëndësishme nga sfera e jetës bashkëshortore.¹⁰

Përveç me norma urdhëruese për shkak të marrëdhënieve mes bashkëshortëve ekzistojnë edhe shumë marrëdhënie martesore të tjera të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv, me marrëveshje të bashkëshortëve (marrëveshje për mbiemrin, për vendbanimin e përbashkët

⁹ *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014

¹⁰ Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005, fq.59

kryerjet e punëve të amvisërisë etj). Martesa në përgjithsi njihet si njëri nga institucionet më të lashta dhe më të rëndësishme juridike dhe shoqërore.

Për natyrën juridike të martesës ekzistojnë dy koncepte kryesore:

- ✓ *Martesa është kontratë civile dhe*
- ✓ *Martesa është institucion juridik.*

I pari që e cilëson martesën si kontratë i ka rrënjët e veta në të drejtën romake dhe ka qenë sanksionuar shprehimisht në legjislacionin kishtar. (*Codex iuris kanonici, canon*). Natyra urdhëruese e normave juridike të cilat zbatohen në rastet e lidhjes së martesës dhe zgjidhjes së martesës të cilat bashkëshortët nuk mund ti ndryshojnë me shprehjen e lirë të vullnetit, kontratës së martesës i japin karakter specifik kundrejt kontratës së shitblerjes apo kontratave tjera civile.¹¹

I dyti e cilëson martesën si institucion juridik, sipas këtij koncepti pohojnë se martesa krijon statusin juridik bashkëshortor për burrin dhe gruan dhe kështu formohet familja; ndërsa martesa ka përmbajtje dhe synim kontratën, subjekt i marrëdhënieve martesore mundet të jetë vetëm një burrë dhe një grua ndërsa tek kontrata civile mundet të ketë dy e më shumë palë kontraktuese; për lidhjen e martesës ekzistojnë pengesa martesore absolute si: gjinia e gjakut në vijë të drejtë pa kufi dhe në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, kurse për lidhjen e kontratave civile nuk janë vënë pengesa të tilla, marrëdhëniet martesore kanë karakter personal dhe si rrjedhojë, natyra dhe përmbajtja e tyre është krejtësisht ndryshe nga ato që krijohen për debitorin dhe kreditorin, kur është fjala për cilindo kontratë dispozitat ligjore për lidhjen dhe zgjidhjen e martesës janë të natyrës urdhëruese. Kështu që në shumë fakte shkojnë në favor se martesa është një institucion juridik. Lidhja e martesës para organit kompetent shtetëror me deklarin e vullnetit të lirë dhe pëlqim të ndërsjellë të bashkëshortëve të ardhshëm përjashton çdo mundësi për të cilësuar martesën si kontratë civile, aq më tepër që shteti e vë nën kujdesje shoqërore dhe mbrojtje shtetërore, si një institucion i rëndësishëm juridik dhe shoqëror.

¹¹ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Drita, M. Fazliu, *Martesa dhe kontrata martesore*, Faculty of Law, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.79

Përfaqësuesit e konceptit se martesë është një kontratë juridike civile, martesën e cilësojnë si jetesë të përbashkët të një burri dhe një gruaje me qëllim që ti ndihmojnë njëri-tjetrit dhe ti rrisin femijët e vet.¹²

Funksioni i rregullt i bashkësisë martesore sa i përket krijimit, administrimit dhe ndarjes së vlerave pasurore që paraqiten si pasojë e jetës së përbashkët të bashkëshortëve është zgjedhur me ndihmën e institutit të regjimit pasuror të bashkëshortëve. Me shprehjen regjim pasuror nënkuptojmë tërësinë e normave juridike me anë të së cilëve rregullohen marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë.¹³

Sipas aspektit historik dhe atij komperativ e drejta pasurore bashkëshortore njeh dy regjime pasurore të bashkëshortëve si regjimin pasuror ligjor dhe regjimin pasuror kontraktor. Në legjislacionet që njohin vetëm regjimin pasuror ligjor aktualisht Republika e Maqedonisë pra legjislacioni i së cilës nuk parasheh regjimin pasuror kontraktor bashkëshortët sipas këtij legjislacioni kanë vetëm një zgjidhje, dhe ata janë të detyruar që ti nënshtrohen vetëm regjimit të përcaktuar me ligj pa pasur të drejtë që me kontratë të meren vesh për ndonjë regjim tjetër alternative e marrëdhëniet e tyre i rregullojnë sipas regjimit pasuror ligjor.¹⁴

Mjafton të dimë dhe të përmendim se saj përket bashkëshortëve, zgjedhja legjislative shprehet mbi bashkësinë ligjore të të mirave materiale ajo që përbën sot regjim ligjor ndërsa më parë ishte ndarja pasurore e të mirave materiale ajo që e përbënte modelin ligjor të regjimit pasuror midis bashkëshortëve. Në zgjedhjen e këtij regjimi është i pranishëm tensioni në realizimin e barazisë midis bashkëshortëve: megjithatë nuk duhet harruar fakti se lirish atë të ndarjes së të mirave materiale, duke zbehur kështu rëndësinë e ndryshimin legjislativ. Kujtojmë se më hyrjen në fuqi të parimit të barazisë merr rëndësi të veçantë, shfyqizimin e normave që parashikonin regjimin pajës që natyrisht kishin lindur në një realitet ku ndërsa dinijeti i gruas zbehej, autoriteti i burrit rritej dhe bëhej më i fuqishëm.

¹² Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005, fq.67.

¹³ Zendeli, Emine, *Contraction property regime of spouses*, Comparative Overview .fq.1

¹⁴ Po aty, fq.2

Bashkëshortët gjatë jetesës së tyre ata punojnë dhe fitojnë të ardhura dhe vin një kohë kur bëhen titullarë të të mirave pasurore të ardhura dhe pasuri të cilat në marrëdhëniet bashkëshortore do ti nënshtrohen regjimeve specifike pasurore në raport me formate tjera të bashkëpronësive.

Hartimi i kontratës i nënshtrohet një regjimi të dyfishtë:

- ✓ *Vlefshmërisë*
- ✓ *Kundërshtueshmërisë*

Nëse flasim për kushtet e vlefshmërisë atëherë duhet të përmendim se kontrata martesore është një kontratë solemne, ku kushtet e sajë janë të lidhura me formën dhe vlefshmërinë. Nëse flasim për kushtet e formës atëherë duhet që të theksojmë se Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë parashikon se kontrata martesore është një kontratë – akt notarial në prani dhe me përlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose ndonjë përfaqësuesi të tyre.¹⁵

Martesa sjell si pasojë për bashkëshortët jo vetëm ndryshimin e statusit të tyre personal, por edhe ndryshimin e regjimit juridik që do t'i zbatohet pasurisë së fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës, nëpërmjet zbatimit të të ashtuquajturit “regjim pasuror martesor”. Titulli i tretë i kod.fam (Republika e Shqipërisë) i titulluar regjimet pasurore martesore, hapet me një kapitull të parë, të titulluar “dispozita të përgjithshme”, i cili përmban 7 dispozita, përkatësisht nenet 66-72 dhe trajton disa rregulla të përgjithshme mbi kontratën martesore. Kodi i familjes, përveç regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, rregullon në mënyrë të detajuar dy regjime kontraktore:

- ✓ *Regjimi i bashkësisë me kontratë;*
- ✓ *Regjimi i pasurive të ndara.*¹⁶

Raporti ndërmjet regjimit pasuror të bashkësisë ligjore dhe regjimit të pasurive të ndara është rregulluar nga parimi i sanksionuar në nenin 66 të kod.fam, sipas së cilit bashkësia ligjore gjen zbatim vetëm në mungesë të një regjimi kontraktor. Ky rregullim ligjori jep një të drejtë të gjerë vendimmarrje bashkëshortëve, për të vendosur që marrëdhëniet e tyre pasurore të rregullohen nga një regjim pasuror kontraktor nga ata të rregulluar nga kod.fam, të lejojnë që marrëdhëniet

¹⁵ Arta Mandro – Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta Familjare*, Tiranë, 2006 fq.322

¹⁶ *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014

pasurore ndërmjet tyre të rregullohen nga bashkësia ligjore duke mos zgjedhur një regjim kontraktor ose së fundi të vendosin me kontratë zbatimin e një regjimi pasuror origjinal të ndryshëm nga regjimet që gjejnë rregullim nga kod.fam.¹⁷

Në shumicën e legjislacioneve europiane përveç regjimit pasuror ligjor është përcaktuar edhe regjimi pasuror kontraktor i bashkëshkëshortëve (Gjermani, France, Austri, Zvicër etj) ndërkohë që me ndryshimet e reja të legjislacioneve familjare ky rregjim është përcaktuar edhe në shumicën e shteteve të ish kampit socialist (Republika e Kroacisë, Sërbisë, Malit të Zi, Shqipërisë etj). Këto legjislacione kanë siguruar një hapësirë të gjërë të lirisë së kontraktimit me anë të së cilës bashkëshortët me anë të kontratës martesore me anë të vullnetit të lirë të tyre plotësojnë zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet pasurore. Ndërkaq Republika e Maqedonisë nuk len hapësirë për vullnetin e lirë të bashkëshortëve pasi që bashkëshortëve ju ofron vetëm regjimin pasuror ligjor.¹⁸

Po ashtu le të përmendim edhe kushtet për lidhjen e martesës. Martesa mund të lidhet vetëm në mënyrë të lirë e me pëlqimin të plotë të personave që duan të lidhin martesë. Familja është celulë shoqërore dhe shtetërore.¹⁹Regjimi i kushteve dhe ndalesave për martesë sipas të drejtës shqipe ka rëndësi të veçantë, sepse:

Përcaktohet (pa) vlefshmëria e martesës - Kjo ndodh sepse lidhja e saj është e bërë mbi bazën e një akti. Përcaktohen personat e ligjimituar për të kundërshtuar lidhjen e martesës. Vetëm nëse kushtet nuk janë ose ndalesat janë sa kohë që martesë ende nuk është e lidhur ajo mund të kundërshtohet e kështu të parandalohet pavlefshmëria e saj në të ardhmen. Përcaktohen motivet e kundërshtimit ose të pavlefshmërisë absolute, këto lidhen vetëm me kushtet dhe ndalesat për martesë të cilat janë përcaktuar rigorozisht nga Kodi i Familjes së Shqipërisë.

¹⁷ Cassano, Giuseppe, *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della Famiglia*, në Trattati, P. Cendon, Milano: Giuffrè Editore, 2006, fq. 345.

¹⁸ Zendeli, Emine, *Contraction property regime of spouses, Comparative Overview*, fq.2

¹⁹ Po aty fq,3

Kushtet thelbësore quhen ata elemente thelbësore të përgjithshëm dhe individuale që duhet të plotësojnë dhe që nuk duhet të mbartin bashkëshortët e ardhshëm në mënyrë që të kenë zotësi për të lidhur martesë. Askush nuk mund të lidh një martesë juridikisht të vlefshme nëse nuk plotëson këto elemente siç janë kushtet.²⁰

Teoria e së drejtës bën dallim midis kushteve dhe pengesave për martesë mbase të dyja lidhen me zotësinë për martesë. Si kushte për martesë quhen ato elemente thelbësore të përgjithshme me mungesën e të cilave martesa do të ishte e pavlefshme. Kushtet janë elemente me ngarkesë positive. Ata duhet të ekzistojnë, të plotësohen prej bashkëshortëve të ardhshëm. Rendi juridik i ka përcaktuar këto kushte si elemente thelbësore të përgjithshme.²¹

Ndërsa pengesat apo ndalesat, ata interpretohen si elemente individuale, evidence e të cilave duhet të verifikohet dhe të kontrollohet rast pas rasti dhe në qoftë se ekzistojnë këta e bëjnë martesën të pavlefshme. Pra këta janë elemente me ngarkesë negative që përcaktohen ose sanksionohen nga ligji. Nga kjo kuptojmë se këta pengesa nuk duhet të ekzistojnë sepse pengojnë në lidhjen e martesës e ndalon lidhjen e saj.²²

Kushtet janë të përgjithshme, ndërsa pengesat janë konkrete. Ato lidhen me një person të caktuar në një rast konkret me një individ konkret.

Si kushte thelbësore për lidhjen e martesës janë:

- ✓ *Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm;*
- ✓ *Gjinitë e kundërta;*
- ✓ *Lidhja e martesës përpara organit kompetent.*

Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm – që martesa e lidhur të jetë e vlefshme e rëndësishme është që deklarimi të bëhet në mënyrën e parashikuar me ligj dhe pa kushtëzime. Që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë pëlqimin e tyre se martesën e lidhin me vullnetin e lirë të tyre dhe pa pengesa dhe ndalesa martesore. Martesa nuk do të jetë e vlefshme në qoftë se bashkëshortët nuk kanë deklaruar pëlqimin e tyre me vullnetin e lirë të tyre por me anë të

²⁰ Bilalli Arta-Mandro, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, *E drejta familjare*, fq. 92

²¹ Po aty fq, 93

²² Po aty fq, 93

shtrëngimit, lajthimit apo kërcnimit, mënyra tjetër dmth ka munguar vullneti i lirë i mbrendshëm i bashkëshortëve të ardhshëm.²³

Deklarimi i vullnetit të lirë të palëve bëhet me shkrim apo me gojë - Deklarimi me gojë shënohet në procesverbal. Deklarimi bëhet në të njëjtën kohë dhe ka rëndësi në aspektin e sigurisë juridike nga shkakut se diferenca eventuale kohore mundëson hapësirë për tërheqjen e pëlqimit të dhënë kohë më parë nga njëri bashkëshort. E rëndësishme është që deklarimi të bëhet në mënyrën e parashikuar në ligj, pa kushtëzime.²⁴

Për të qenë një martesë e vlefshme, vullneti i shprehur duhet të ketë cilësitë e caktuara

- ✓ *Të jetë real e jo simulative (i deklaruar për të arritur ndonjë qëllim të caktuar e jo për lidhjen e martesës);*
- ✓ *Të jetë serioz e jo i shprehur për shaka;*
- ✓ *Dy deklarata duhet të jepen në të njëjtën kohë suksesivisht në çastin e lidhjes së martesës.*

Secili bashkëshort vullnetin e vet duhet ta shpreh personalisht dhe veç e veç e kjo nënkupton prezencën e bashkëshortëve. Deklaratën e jep një herë njëri pastaj tjetri bashkëshort, deklarata duhet të jetë e përputhshme e shprehur shprehimisht në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë në aspektin e qëllimit. Dhe deklarimi duhet të bëhet në mënyrën e përcaktuar në ligj, pa kushtëzime.²⁵

Gjinitë e kundërta – Gjinitë e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor, dhe civilizues të një martese. Shikuar historikisht martesë ka qenë një privilegj i gruas dhe i burrit, pra i dy personave të gjinive të kundërt. Qëllimi natyror i martesës ka qenë krijimi dhe mirëritja e fëmijëve.

Vetë natyra e martesës ju përket dy personave me gjini të kundërt pra burrit dhe gruas. Mungesa e gjinive të kundërta paraqet pengesë absolute për lidhjen e një martese, kjo sepse martesë është bashkësi jetësore e një burri dhe një gruaje dhe si e tillë është përkufizuar në shumë dispozita të ligjit të familjes së Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

²³ Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005, fq.67

²⁴ Po aty fq, 72

²⁵ Po aty fq ,73

Kjo shpie në konkludim se martesë e personave me gjini të njëjtë nuk është e lejuar sipas ligjit për Familje të RM-së. Lidhja e martesës mes dy personave me gjini të njëjtë nuk është e lejueshme ngase kjo është në kundërshtim me qëllimin natyror të martesës si bashkësi e vazhdueshme e dy personave me gjini të kundërta.²⁶ Mirëpo ka shumë raste në praktikë ku martesë është lidhur mes personave homoseksual apo edhe me gjini të njëjta. Sidomos në kohët e lashta kur shkuesi ndërmjetësonte lidhjen e martesës ndërsa dhëndri dhe nusja nuk takoheshin dhe nuk njiheshin deri në natën e martesës. Kështu që bashkëshortët nuk kanë qenë në mundësi që të vërtetojnë mbi homoseksualitetin e tjetrit. Ndërsa sipas nivelit të kohëve të fundit zhvillimi i kulturës, emancipimi dhe edukimi i femrës përkrah mashkullit ka zvogluar mundësitë e martesës së dy personave me gjini të njëjtë. Është çështje e ekspertizës mjeko-ligjore për të vërtetuar nëse njëri bashkëshort apo të dy bashkëshortët kanë organe gjinore të njëjta. Dhe në qoftë se vërtetohet se të dy bashkëshortët janë të së njëjtës gjini atëherë martesë do të jetë absolute nule. Për vërtetimin e llojit të organit nuk bëhet kontrollë mjeksor i organëve gjinore të bashkëshortëve me rastin e martesës por kjo bëhet në mënyrë vizuale me rastin e lindjes dhe regjistrohet në librat e amzës.²⁷

Lidhja e martesës përpara organit kompetent – deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me gjini të kundërt përmban në vete dy komponente:

- ✓ *Vullneti të jetë i shprehur para organit kompetent për lidhjen e martesës dhe*
- ✓ *Në mënyrën e parashikuar në ligj.*

Martesa lidhet përpara nëpunësit të gjendjes civile - Nuk mund të jetë e vlefshme martesë në qoftë se nuk është lidhur përpara organit kompetent, sepse në këtë mënyrë nuk plotësohet kushti thelbësor i saj i parashikuar me ligj. Edhe komponenti i dytë mënyra e parashikuar në ligj është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e një martesë. Me formën e lidhjes së martesës nënkuptojmë edhe prezencën e dy bashkëshortëve, dy dëshmitarëve dhe nëpunësit e gjendjes civile. Në qoftë se në rastin e lidhjes së martesës nuk kanë qenë të plotësuar ndonjëra nga kushtet atëherë konsiderohet se një martesë e tillë as që ka ekzistuar.

²⁶ Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005, fq.73

²⁷ Po aty fq, 74

Ndërsa martesë që nuk është e lidhur sipas asaj që është parashikuar me ligj është nulë. Pra që një martesë të jetë e vlefshme duhet që lidhja e saj të bëhet para organeve kompetente për lidhjen e martesës në mënyrën e parashikuar me ligj.²⁸

Pengesat për lidhjen e martesës - lidhur me pengesat e lidhjes së martesës ato interpretohen si elemente individuale, ekzistenca e të cilave duhet të verifikohet dhe të kontrollohet rast pas rasti, sepse në qoftë se këta ekzistojnë atëherë e bëjnë të pavlefshme martesën. Nëse i shprehim në mënyrë figurative keto janë elementet me ngarkesë negative që përcaktohen dhe sanksionohen të tilla nga ligji.²⁹

Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut dhe që kërkon detyrimisht një pjekuri fizike dhe intelektuale të mjaftueshme për të marrë përsipër detyra dhe të drejta dhe përgjegjësi emocionalisht dhe realisht.³⁰

Ndalesat për martesë janë:

Mungesa e status liberum - që do të thotë se në çastin e lidhjes së martesës së re njeri ose të dy bashkëshortet janë në një raport martesor ekzistues dhe nuk janë në kushtet e gjendjes së lirë. Statusi liberum nuk ekziston nëse ende nuk ka mbaruar martesë e mëparshme. Sipas legjislacionit shqipëtar, respektohet parimi i martesës monogame. Kjo lloje ndalesë është e detyrueshme dhe ndikon në martesë, duke i shkaktuar pavlefshmëri absolute nëse nuk respektohet. Nuk shkaktohet ndalesa nëse martesë e mëparshme për shkak të vdekjes së bashkëshortit ose shpalljes së vdekur, nuk pengon lidhjen ose shpalljen e pavlefshmërisë së martesës së re dhe nuk e vë në rrezik parimin e monogamies.³¹

Lidhjet e gjakut - përbëjnë ndalesë për martesë lidhjet e gjakut në vijë të drejtpërdrejtë pa kufizime dhe në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt përderisa si rregull janë të ndaluara martesat midis fëmijëve të vëllezërve dhe motrave.³²

Lidhjet e krushqisë - përbëjnë ndalesë për martesë lidhjet afinitive siç janë ata në mes vjerit dhe nuses; njerikut dhe thjeshtës.

²⁸Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005, fq.75

²⁹ Bilalli Arta - Mandro, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, *E Drejta Familjare*, fq.94

³⁰ Po aty fq, 95

³¹ Po aty fq, 103

³² Po aty fq, 108

Kjo martesë është e ndaluar edhe në rast se martesë që e ka krijuar ose e ka prodhuar këtë lidhje, është shpallur e pavlefshme ka pushuar ose është zgjidhur që dmth ose është shpallur e pavlefshme ose ka pushuar.³³

Sëmundja psikike ose zhvillimi i metë mendor - përbën ndalesë për martesë, ekzistenca të njëri nga bashkëshortët e ardhshëm e gjendjes së të sëmurit rëndë psikikisht ose me zhvillim të metë mendor e tillë që bën të pamundur të kuptuarit e qëllimit të martesës.³⁴Familja është qeliza bazë e shoqërisë dhe ajo ka nevojë për subjekte të matura dhe të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që burrojnë nga martesë.³⁵

Pas lindjes dhe vdekjes lidhja e martesës është një nga momentet më të rëndësishme në jetën e njeriut. Forma e lidhjes së martesës është civile. Për herë të parë forma civile e detyrueshme për lidhjen e martesës në Shqipëri parashihet me Kodin civil të vitit 1929. Martesë celebrhet përpara nënpunësit të gjendjes civile të bashkësisë ose të komunës. Ajo më vonë është parashikuar edhe në kodet e mëvonshme të familjes. Martesë lidhet përpara nënpunësit të gjendjes civile sepse martesë që nuk është e lidhur publikisht dhe para nënpunësit të gjendjes civile është martesë e pavlefshme. Forma e lidhjes së martesës tregon edhe një herë se e drejta jonë hynë në kuadrin e të drejtave formaliste në çështje që lidhen me familjen dhe martesën.

Këtë karakteristikë e kanë trashëguar nga e drejta romake të gjitha legjislacionet që i përkasin sistemit kodifikues. Kjo nuk pengon bashkëshortët e ardhshëm që të organizojnë ceremonial nga më të ndryshmet si në kishë apo xhami, por kjo në qoftë se nuk është celebruar sipas kriterëve ligjore nuk është e njohur juridikisht dhe nuk mbrohet nga legjislacioni familjar.³⁶

Forma solemne dhe lidhja e martesës lokale e posaçme zyrtare, forma civile dhe prezenca e personelit të caktuar me rastin e lidhjes së martesës, lokali i posaçëm dhe atmosfera solemne e cila krijohet tregojnë për rëndësinë e madhe që ka akti i lidhjes së martesës për bashkëshortët nga njëra anë, kurse nga ana tjetër për interesimin dhe mbrojtjen e veçantë shtetërore dhe shoqërore që gëzon institucioni i martesës, dhe se fundi publiciteti dhe solemniteti i lidhjes së martesës

³³ Bilalli Arta - Mandro, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, *E Drejta Familjare*, fq.112

³⁴ Po aty fq,113

³⁵ Po aty fq,113

³⁶ Po aty fq,119

mundësojnë të provuarit më të lehtë të ekzistimit të martesës në rastet e nevojshme (forma ad probationem).³⁷

Si elemente kryesore të formës së lidhjes së martesës cilësohen:

- ✓ *Kompetenca për lidhjen e martesës, dhe*
- ✓ *Mënyra për lidhjen e martesës.*

Kompetenca për lidhjen e martesës - dallojmë kompetencën lëndore, tokësore dhe funksionale. Me kompetencë lëndore nënkuptojmë rrethin e punëve të organit të autorizuar për lidhjen e martesës dhe kjo çështje është rregulluar me norma të karakterit urdhërues. Kompetenca tokësore me të cilën kuptojmë territorin mbrenda të cilit e ushtron funksionin e vet organi për lidhjen e martesës, në juridiksionin e të cilit njëri nga bashkëshortët e ka vendbanimin ose vendqendrimin. Kompetenca funksionale nënkuptojmë funksionet e personelit zyrtar pjesëmarrës në procesin për lidhjen e martesës në bazë të autorizimeve që rezultojnë nga normat ligjore.³⁸

Mënyra e lidhjes së martesës - mënyra e lidhjes së martesës paraqet tërësinë e rregullave të cilat duhet respektuar me rastin e lidhjes së martesës. Mënyra e lidhjes së martesës është rregulluar detajisht me norma ligjore. Dhe mosrespektimi i tyre shkakton nulitetin e martesës.³⁹

Martesa krijon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh midis bashkëshortëve ashtu që burri dhe gruaja kanë të drejta dhe detyrime të barabarta (reciproke) andaj sot pikërisht martesa pa asnje lloj diskriminimi fetar kombëtar racor apo midis gjinive të kundërta ngrihet mbi bazën e barazisë morale dhe juridike e përcaktuar me ligj. Ndonëse martesa në pozitën juridike të bashkëshortëve nuk ndryshon gjithsesi ajo ndryshon në shumëçka si në mënyrën e jetesës së tyre nga beqar i martuar apo shkurorëzuar. Sipas rregullativës ligjore bashkëshortët nuk mund të jenë bartës të së drejtave dhe detyrimeve në qoft se nuk kanë zotësinë për të vepruar.

Në fakt martesa as nuk na ngushton e as nuk na zgjeron zotësinë e veprimit përveçse që jua mundëson personave të martuar më të vjetër se 16 vjeç të fitojnë zotësinë e veprimit edhe pa e mbushur moshën madhore 18 vjet në çastin e lidhjes së martesës që d.m.th emancipohen.⁴⁰

³⁷ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005, fq.91

³⁸ Po aty fq,92

³⁹ Po aty fq,93

Ku sipas ligjit të familjes së Republikës së Maqedonisë neni 16 thotë: Nuk mund të lidhë martesë personi i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeçare. Gjykata kompetente ka mundësi që në procedurë jokontestimore ti lejojë lidhjen e martesës personit i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeçare nëse verteton se ai e ka arritur pjekurinë fizike dhe psikike të nevojshme për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që krijohen në martesë dhe pas sigurimit të mendimit të institucionit shëndetësor dhe ndihmës profesionale të ofruar nga Qendra për punë sociale. Një numër i të drejtave personale të bashkëshorteve nuk mund të rregullohen me norma juridike ata janë psikologjike, biologjike e të karakterit moral që përbëjnë intimen e njeriut, këta marrdhënie nuk kan ngelur jashtë sferës së interesimit shoqëror por jashtë sferës së rregullimit juridik. Marrëdhëniet e tilla janë objekt rregullimi me norma etike.

Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve ndahen në:

- ✓ Të drejta dhe detyra personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe
- ✓ Të drejta dhe detyra personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.⁴¹

Të drejta dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje: Këto të drejta janë të rregulluara në normat e karakterit urdhërues si: jetesa e përbashkët e bashkëshortëve, barazia e bashkëshortëve, pavarësia e bashkëshorteve në zgjedhjen e punës e të profesionit, besnikëria bashkëshortore dhe ndihma reciproke mes bashkëshorteve. Jetesa e përbashkët e bashkëshortëve përben përmbajtjen dhe qëllimin e martesës.⁴²

Janë të pavlefshme martesat të cilat janë lidhur me qëllim si trashëgimi ligjor apo për t'iu ikur nga përgjegjësia e veprave të kryera penale gjithashtu martesa e lidhur pa qëllim të jetesës së përbashkët është e pavlefshme.⁴³

Bashkëshortët nuk mund të vendosin për jetesën e përbashkët - jetesa e përbashkët e bashkëshortëve është e rregulluar me norma të natyrës *ius cogens*, që dmth se bashkëshortët duhet të vendosin me marrëveshje për caktimin e vendbanimit në mënyrën që është e paraparë me dispozita ligjore.

⁴⁰ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005, fq.101

⁴¹ Po aty fq,102

⁴² Po aty fq,102

⁴³ Po aty fq,103

Për shkaqe të ndryshme si psh. punësimi i përkohshëm në botën e jashtme, marrja me aktivitete sportive kombëtare apo ndërkombëtare, studim mundet të jetë pengesë që bashkëshortët të jetojnë ndaras jashtë vendbanimit të përbashkët. Vendbanimi ndaras i përkohshëm nuk mund të jetë shkak për pavlefshmerine e martesës. Mirëpo nëse bashkëshortët nuk bien jetesë të përbashkët dhe nuk i kryejnë detyrimet ndaj njeri-tjetrit ata mund të sanksionohen me zgjidhje të martesës, në qoftë se njeri nga bashkëshortët inicon procedurë para gjykatës kompetente për zgjedhjen e saj.⁴⁴

Barazia e bashkëshortëve - barazia e bashkëshortëve është e garantuar me dispozita kushtetuese bashkëshortët në martesë janë të barabarta në të gjitha marrëdhëniet personale dhe jo vetëm aq por edhe në marrëdhëniet pasurore edhe pse ligji nuk parasheh sanksion të drejtpërdrejtë për shkeljen e parimit të barazisë të bashkëshortëve por ajo mund të shkaktojë padurueshmërinë e marrëdhënieve martesore dhe të arrijë deri tek zgjidhja e martesës.⁴⁵

Pavarësia e bashkëshortëve për të zgjedhur punën dhe profesionin - kjo e drejtë bashkëshortëve u garantohet me dispozita ligjore që dmth bashkëshortët kanë të drejtë për të zgjedhur punën dhe profesionin e tyre. Kjo nënkupton secilit bashkëshortë që në mënyrë të pavarur me vullnetin e tij të lirë si dhe pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër ka të drejtë për zgjedhjen e profesionit të tij që do ta ushtroje.⁴⁶

Detyrimi i ndihmës dhe i respektit - Jetesa e përbashkët e bashkëshortëve në të cilën haset mbështetja morale dhe emocionale e bashkëshortëve i jep kuptim saj. Detyrimi i ndihmës dhe i respektit manifestohet në dy rrafshë në atë morale dhe materiale. Respektimi i integritetit moral të bashkëshortit tjetër është një ndër parakushtet për funksionimin e hareshëm të bashkësisë martesore. Jeta e përbashkët martesore do ta humbiste kuptimin e saj në qoft se njeri bashkëshort nënçmon ose fyen bashkëshortin tjetër veçmas ose në prezencën e të tjerëve.

Ndërsa ndihma materiale nënkupton ndihmë e ndërsjelltë në mënyrat më të llojllojshme, kjo ndihmë mund të jetë ushqim, shkollim, sherim, veshmbathje etj. Mos respektimi i këtyre

⁴⁴ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005, fq.104

⁴⁵ Po aty fq,105

⁴⁶ Po aty fq,106

detyrimeve mund të jetë shkas për zgjidhjen e martesës si dhe të shkaktoj probleme të thella martesore.⁴⁷

Besnikëria e përbashkët - Bashkëshortët duhet ti qëndrojnë besnik njëri-tjetrit po aq sa zgjaten lidhja e martesës që nënkupton prej çastit të lidhjes së martesës deri në pushimin e saj. (Me shkurrezimin e martesës ose me vdekjen apo deklarimin e bashkëshortit të vdekur) edhe në qoftë se martesa e tyre është në fund të zgjidhjes së saj ata kanë detyrë ti qëndrojnë besnik njëri-tjetrit derisa de jure nuk zgjidhet martesa.⁴⁸

Shkelja e besnikërisë mund të jetë në forma të tradhëtisë së njërit bashkëshortë, në formë prostitucioni ose të bigamisë nga ana e bashkëshortit tjetër.⁴⁹Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortet mund të bëjnë marrëveshje këto të drejta dhe detyrime janë të rregulluara me norma atë karakterit dispozitiv këto të drejta dhe detyrime janë:

- ✓ *Caktimi i mbiemrit familjar,*
- ✓ *Caktimi i vendbanimit,*
- ✓ *Lindja e fëmijeve dhe ekonomia e përbashkët familjare,*
- ✓ *Caktimi i shtetësisë.*⁵⁰

Caktimi i mbiemrit familjar - ligji për caktimin e mbiemrit u lë bashkëshortëve në dispozicion shumë alternative, mbiemri caktohet me marrëveshje të bashkëshortëve, mundet që bashkëshortët secili të mbaje mbiemrin e vet që njëri të marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër dhe ti bashkangjitet mbiemrit të vet, mundet që i përbashkët të jetë mbiemri i njërit bashkëshort për të dy bashkëshortët mirpo kombinimi mbiemrit nuk do të jetë i mundur nëse mbiemrat përfshihen nga mbiemra të dyfishtë.⁵¹

Në truallin Shqiptare si zakonisht gruaja mer mbiemrin e burrit, mirëpo si pasojë e reformave të reja shpesh ka raste kur gruaja mban mbiemrin e vet të vajzërisë dhe pas martesës ose mbiemrit të vajzërisë i bashkangjet mbiemrin e burrit kjo ndodh sidomos kur është fjala për nuse

⁴⁷ Po aty fq,106

⁴⁸ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005, fq.104

⁴⁹ Po aty fq,105

⁵⁰ Po aty fq,106

⁵¹ Po aty fq,106

intelektuale e të arsimuara. Vendimi i bashkëshortëve mundet të jetë i përkohshëm sepse mundet të ndërrojnë mbiemrin martesor edhe gjatë qenies në martesë.⁵²

Caktimi i vendbanimit - për caktimin e vendbanimit vendosin lirisht bashkëshortët. Bashkëshortët mund të meren vesh si të duan për (domicilin) vendqendrimin dhe vendbanimin. E drejta e lashtë zakonore parashihte se gruaja duhet të shkoje pas burrit e të banoje atje ku ai jeton ose ku ai gjen më së miri. Mirëpo kohëve të sodit bashkëshortët vete vendosin me marrëveshje për vendbanimin e tyre. Edhe pse për shkaqe të studimeve apo aktiviteteve sportive, punës së përkohëshme në botën e jashtme bashkëshortëve mund të ju ndodh që të jetojnë shpesh të ndarë në qytete apo shtete të ndryshme por kjo nuk është shkak për zgjidhjen e martesës ndërsa mosjetesa e përbashket pa arsye mund të jetë shkak për zgjidhjen e martesës.⁵³

Vendosja per numrin e fëmijëve dhe kryerjen e punëve në bashkësi martesore - është një ndër të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta që bashkëshortët me marrëveshje vendosin bashkarisht për numrin e lindjes së fëmijëve, për rritjen e tyre për shkollimin e tyre që d.m.th se si do ti arsimojnë do ti shkollojnë e shumë e shumë çështje të tjera të ndryshme për mirëritjen e fëmijëve në mënyrë të duhur me këto marrëveshje bashkëshortët arrijnë të ashtuquajturën detyrimin themelor të prindërve.⁵⁴

Me marrëveshje bashkëshortët gjithashtu vendosin ndaj punëve rreth ekonomisë së përbashket shtëpiake siç janë: përgatitja e ushqimit, furnizimi me gjëra të domosdoshme dhe artikuj ushqimore, pastrimi i shtëpisë etj. Kjo është në harmoni me barazinë e gruas dhe burrit dhe dëshirave të tyre. Mosmarrëveshjet rreth këtyrë çështjeve e bëjnë të padurueshme jetën e përbashket bashkëshortore dhe e shpiejnë atë deri në zgjidhjen e martesës.⁵⁵

Caktimi i shtetësisë - shtetësia është lidhje juridike midis një njeriu dhe një shteti me anë të së cilës mbi atë person ushtrohen veprimi i ligjit të po atij shteti duke u krijuar të drejtat dhe detyrimet të caktuara reciproke. Me rastin e martesës bashkëshortët nuk janë të detyruar që të marrin shtetësinë e bashkëshortit tjetër , d.m.th nëse ato dëshirojnë të ndrojnë shtetësinë varet nga

⁵² Po aty fq,106

⁵³ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005,fq.107

⁵⁴ Po aty fq,108

⁵⁵ Po aty fq,108

vet dëshira e bashkëshortëve që domethënë se ajo pas martesës mundet ma resh shtetësinë e bashkëshortit të saj ose të mbajë shtetësinë që e kishte para martesës.⁵⁶

1.2 TË DREJTAT PASURORE DHE PASURIA E VEÇANTË E BASHKËSHORTËVE

Regjimi pasuror martesor i njohur si regjimi pasuror martesor është regjimi ligjor që rregullon marrëdhëniet martesore të pronës, por edhe një pjesë integrale e martesës dhe familjes, martesën, partitë regjimit pasuror martesor përgjegjësi të qartë ligjor të martesës dhe familjes, për mbrojtjen e personit të ri dhe të vjetër të sëmurë i jetës, dhe për të promovuar jetë të qëndrueshme familjare është e rëndësishme, bazuar në teorinë e regjimit martesor pronë për të analizuar defektet e sistemit pasuror martesor, dhe të propozojë masa për të përmirësuar më tej, sistemi prona martesore lloj letër, një sistem ligjor të qartë martesor fiskale, sistem unik pasuror martesor, koncepti i sistemit pasuror martesor, natyra. Përmbajtja kryesore e legjislacionit të para regjimit të pasurisë bashkëshortore dhe regjimin e pasurisë bashkëshortore, duke theksuar mangësitë e sistemit aktual të pronës martesore, dhe sipas teorisë e përgjithshme e sistemit pasuror martesor, për të përmirësuar më tej masat e vënë përpara në mënyrë që të bëjë sistemin pasurinë tonë më të përsosur martesore . Sistemin e përbashkët të pronësisë, dhe nuk ka një sistem të veçantë pasuror martesor në të gjitha.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve në vështrim të dispozitave të këtij ligji është ajo pasuri që bashkëshortët e krijojnë gjatë kohëzgjatjes së martesës. Siç mund të konstatohet nga ky përkufizim, ligjdhënësi nuk përmend shprehjen punë si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët ashtu siç kanë vepruar ligjdhënësit në njësitë e ish - federatës jugosllave pjesë e së cilës ka qenë edhe Republika e Maqedonisë. Gjatë zgjedhjes së kontesteve pasurore ndërmjet bashkëshortëve gjykata e mer vesh punën si bazë juridike për fitimin e pasurisë së përbashkët edhe atë të gjitha llojet e punës që mund të vijnë në shprehje qofshin punë që kanë efekt të drejtpërdrejt financiar apo punë që kontribuojnë në rruajtjen e fitimit.⁵⁷ Martesa është kusht i dytë për krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, pra përveç përbushjes së supozimit

⁵⁶ Podvorica Hamdi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2005, fq,108

⁵⁷ Zendeli Emine, 2014, *Perspective of regulaton of property relations of spouses in the legal system of the Republic of Macedonia*, Vizione , fq. 278-285

formal-juridik, faktit se është lidhur martesë, për egzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve është e domosdoshme në momentin e fitimit të pasurisë ndërmjet bashkëshortëve. Përndryshe e gjithë ajo që është krijuar pas pushimit e bashkësisë martesore edhe pse është krijuar përderisa martesë ka qenë ende në fuqi juridikisht do të konsiderohet si pasuri e veçantë. Kohëzgjatja e bashkësisë martesore paraqet përcaktimin kohor prej cilit moment duhet që një send të futet në bashkësi martesore dhe të konsiderohet si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve.⁵⁸

Edhe pse në Republikën e Maqedonisë dhe ai i Kosovës ligjdhënësi nuk përmend shprehjen bashkësi martesore, por shprehjen martesë dhe në këtë kontest ka tre nocione që duhet të sqarohen dhe që janë mjaft të rëndësishme për egzistimin e pasurisë së përbashkët “martesë”, “bashkësia martesore”, “jeta e përbashkët martesore”.⁵⁹

Nocioni martesës nënkupton kornizën institucionale të marrëdhënies e cila krijohet me anë të deklaratës së vullnetit të lirë të dy personave me gjini të kundërt. Ajo krijohet me akt solemn formal, dhe nga moment i lidhjes së martesës dhe deri në pushimin e saj ekzistojnë të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve. Me bashkësinë martesore nënkuptojmë egzistimin e elementeve themelore të martesës me anë të së cilave realizohen qëllimet e saj. Bashkësia martesore mund të zgjat me shkurt ose më gjatë se martesë prandaj periudha nga lidhja e martesës deri në pushimin e bashkësisë martesore është relevante për vlersimin e egzistimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në këtë kontest çdogjë që është krijuar në periudhën e lidhjes së martesës e deri në pushimin e saj do të konsiderohet si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve dhe ajo që është krijuar pas pushimit të përhershëm të martesës do të ngelet si pasuri e veçantë e bashkëshortëve. Kështu nuk do të konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkëshortëve paluajtshmëria e blerë nga njëri bashkëshort pas ndërprerjes së bashkësisë martesore, por para shkurorëzimit të martesës. Gjithashtu nuk konsiderohet pasuri e përbashkët ndërtesa e banimit të cilën e ka ndërtuar njëri prej bashkëshortëve pas ndërprerjes së bashkësisë së martesës, edhe atëherë kur për ndërtimin e saj ka përdorur pjesë nga ndërtesa e përbashkët d.m.th të drejtën mbi këtë ndërtesë do ta këtë bashkëshorti që e ka ndërtuar ndërkohë që bashkëshorti tjetër do të këtë vetëm kërkesë detyrimore në proporcion me pjesët e përdorura

⁵⁸Zendeli Emine, 2014, *Perspective of regulaton of property relations of spouses in the legal system of the Republic of Macedonia*, Vizione , fq. 278-285

⁵⁹Po aty.

nga ndërtesa e përbashkët.⁶⁰ Jeta e përbashkët bashkëshortore është nocion më i ngushtë se bashkësia martesore për shkak se jeta e përbashkët bashkëshortore paraqet një nga elementet materiale të egzistimit të bashkësisë martesore dhe kjo nënkupton përmbushjen elementit hapsinor të saj. Pasuri e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e çdonjërit nga bashkëshortët e cila nuk i është nënshtruar regjimit juridik të pasurisë së përbashkët. Në pasuri të veçantë hynë të gjitha ato sende që bashkëshortët i kanë krijuar para lidhjes së martesës. Ka edhe një kategori e sendeve që llogariten pasuri të veçantë të bashkëshortëve si: dhurata, testament, legu etj. Gjithashtu në pjesën e pasurisë së veçantë janë edhe sendet që njëri nga bashkëshortët i ka fituar në bazë të trashëgimisë dhuratës, gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore.

Regjimi pasuror martesor i njohur si regjimi pasuror martesor është regjimi ligjor që rregullon marrëdhëniet martesore të pronës, por edhe një pjesë integrale e martesës dhe familjes, martesën, partitë regjimit pasuror martesor përgjegjësi të qartë ligjor të martesës dhe familjes, për mbrojtjen e personit të ri dhe të vjetër të sëmure i jetës, dhe për të promovuar jetë të qëndrueshme familjare është e rëndësishme, bazuar në teorinë e regjimit martesor pronë për të analizuar defektet e sistemit pasuror martesor, dhe të propozojë masa për të përmirësuar më tej, sistemi prona martesore lloj letër, një sistem ligjor të qartë martesor fiskale, sistem unik pasuror martesor, koncepti i sistemit pasuror martesor, natyra. Përmbajtja kryesore e legjislacionit të para regjimit të pasurisë bashkëshortore dhe regjimin e pasurisë bashkëshortore, duke theksuar mangësitë e sistemit aktual të pronës martesore, dhe sipas teorisë e përgjithshme e sistemit pasuror martesor, për të përmirësuar më tej masat e vënë përpara në mënyrë që të bëjë sistemin pasurorinë tonë më të përsosur martesore.⁶¹

⁶⁰ Zendeli Emine, 2014, *Perspective of regulaton of property relations of spouses in the legal system of the Republic of Macedonia*, Vizione , fq. 278-285

⁶¹ Po aty.

1.3 NDARJA E PASURISË SË PËRBASHKËT

Gjatë jetës së përbashkët, bashkëshortët ndodh shpesh që të mos dakordohen lidhur me disponimin me sendet e pronësisë së përbashkët dhe administrimin e tyre. Mospajtimet mund të shkaktohen edhe në rastet kur ekzistojnë obligime të bashkëshortëve që janë krijuar para lidhjes së martesës dhe ai nuk e sheh në gjendje që ti përmbush vetëm nga pasuria e veçantë e tij, në këto raste ata kanë në disponim të drejten e ndarjes së sendeve nga pasuria e përbashkët e tyre.⁶²

Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë ka promovuar sistemin e ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta, por edhe pse ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i vitit 2001 i Republikës së Maqedonisë, ka krijuar supozimin ligjor sipas të cilit me rastin e pushimit të martesës bashkëshortëve u takojnë pjesë të barabarta nga pasuria e përbashkët, megjithatë në praktikë janë të shpeshta rastet kur supozimi ligjor i shprehur në nenin 75 al.2, paraqitet si kontestues, prandaj mundësia e padrejtësisë eventuale që mund të sjellë ndarje të pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta është korigjuar me nenin 75, al.3 të ligjit për pronësi ku është paraparë mundësia që me kërkesë të bashkëshortit, gjykata në procedurë gjyqësore ti përcaktojë pjesë më të madhe bashkëshortit i cili arrinë të kontribuojë në krijimin e pasurisë së përbashkët është dukshëm më i madh. Supozimi ligjor i ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta përveç nga bashkëshorti mund të kontestohet edhe nga trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të shpallur të zhdukur për të vdekur.⁶³

Dhurata që bashkëshortët i kanë bërë njëri tjetrit para lidhjes së martesës ose gjatë kohëzgjatjes së saj me rastin e ndarjes nuk kthehen. Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i vitit 2001 nuk përmban dispozita lidhur me fejesën e cila del nga interpretimi i shprehjes “Para martesës”, megjithatë në një vend të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë thuhet se motivet kryesore me rastin e dhënies së dhuratës ka qenë lidhja e martesës ndërmjet të fejuarve ndërkohë që nuk ka ardhur deri tek lidhja e martesës, bie baza për të cilën jepet dhurata dhe duke u vepruar sipas rregullave të pasurimit të pa bazë dhuratat e tilla duhet të kthehen.

⁶² Zendeli Emine, 2014, *Perspective of regulaton of property relations of spouses in the legal system of the Republic of Macedonia*, Vizione , fq. 278-285

⁶³ Po aty.

Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër martesor kështu e përkufizon Ligji për Familje në Republikën e Shqipërisë.⁶⁴

1.3.1 NDRYSHIMI I REGJIMIT PASUROR MARTESOR


Nëse flasim për regjimin pasuror martesor në këtë emërtim kemi rregullat që kanë të bëjnë me pasurinë e bashkortëve. Fjala “*regjim*” nënkupton se sipas vlerësimit të tyre, bashkëshortët mund të zgjedhin dhe të vendosin mbi rregullat që do të respektojnë lidhur me pasurinë martesore dhe përbërjen e sa regjimet kryesore pasurore janë dy: regjimi “me ligj” dhe regjimi “me kontratë”. Në rastin e parë, rregullat kryesore lidhur me përbërjen e pasurisë vetjake të bashkëshortëve dhe të asaj që krijohet si pasuri e përbashkët gjatë martesës e njohur me emrin pasuri e “bashkësisë”, e përcaktuar nga Kodi i Familjes. I dyti, është regjimi me kontratë i cili shfaqet në formën e bashkësisë me kontratë ose në formën e pasurive të ndara. Sipas tij, çdo gjë (pasurore) është e ndarë që në fillim dhe kështu do të jetë në vijimësi. Quhet me kontratë sepse janë bashkëshortët ata që, përmes një kontrate noteriale të veçantë vendosin nëse do të kenë pjesë pasurie bashkë, apo do të kenë gjithçka të ndarë. Asnjë prej bashkëshortëve nuk mund t'i imponojë tjetrit zgjedhjen e një regjimi për pasurinë. Vendimi për këtë, është e drejtë e barabartë e të dy bashkëshortëve. Por, nëse martohet me leje të gjykatës një vajzë (djalë) që nuk ka mbushur 18 vjeç, në këtë rast bëhet i detyrueshëm regjimi me ligj (regjimi i bashkësisë ligjore).

- ✓ *Kur mund të zgjedhin bashkëshortët një regjim?*
- ✓ *Si?*
- ✓ *A mund të ndryshohet një regjim i vendosur?*
- ✓ *Sa herë dhe në ç'mënyrë?*

Çdo regjim fillon të veprojë vetëm me lidhjen e martesës. Nëse çifti nuk përfundon në martesë, atëherë s'ka vend për regjim. Kështu, sa kohë nuk janë të martuar, ata kanë të drejtë edhe t'i ndryshojnë rregullat lidhur me pasurinë sa herë të dëshirojnë. Pasi martohen, regjimi nuk ndryshohet lehtësisht.

⁶⁴ Ligj Nr.9062, data 8.5.2003, *Kodi i Familjes*, pjesa e dytë – bashkëshortët.

Nëse çifti dëshiron të ndryshojë regjimin, kërkohet që të kenë kaluar 2 vjet dhe kjo të justifikohet me interesin e familjes që e kërkon një gjë të tillë. Përcaktimi i regjimit me kontratë të pasurisë së bashkëshortëve nuk është i njëjtë me kontratën e zakonshme. Ka disa rregulla që nuk mund të ndryshohen pavarësisht ndonjë dëshirë të tyre, sepse mbrohet familja, fëmijët, martesat. Në një situatë të tillë ata duhet të shkojnë detyrimisht tek noteri, i cili u shpjegon çdo rregull dhe i lehtëson juridikisht. Sa herë ndryshohet regjimi duhet të paraqiteni përpara noterit, sepse regjimi duhet të fiksohet në një “akt noterial”. Nëse bashkëshortët nuk kanë zgjedhur një regjim me kontratë, kjo do të thotë se ata duan të rregullojnë çështjet pasurore sipas ligjit. Në këtë rast, ata nuk ka përse të shkojnë tek noteri, pasi problemet pasurore, rregullohen nga Kodi i Familjes.⁶⁵



⁶⁵ Raport nga OSCE, përgatitur nga Aurela Anastas, *Të drejtat e gruas në Legjislacioni Shqipëtarë*

Regjimi martesor, ligjor me marrëveshje mund të ndryshohet me kontratën midis bashkëshortëve tërësisht ose pjesërishtë pasi të plotësohen disa kushtë të parashikuara në Kodin e Familjes. Me lidhjen e martesës, mes bashkëshortëve krijohen jo vetëm marrëdhënie me karakter personal por edhe marrëdhënie me karakter pasuror. Marrëdhëniet pasurore klasifikohen në marrëdhënie me karakter periodik, që lidhen me shpenzimet e jetës së përditshme duke përfshirë këtu kontributin material që secili bashkëshort jep për mbarëvajtjen e familjes, dhe marrëdhënie që e tejkalojnë këtë kuadër. Këto të fundit lidhen me pasurinë që secili prej bashkëshortëve mund të fitojë gjatë martesës. Mund të ndodhë që bashkëshorti, pasi ka përmbushur detyrimin për kontribut material në interes të familjes, të ketë të ardhura të tjera. Këto të ardhura ai mund të vendosë t’i investojë, t’i përdorë për të blerë sende të luajtshme apo të paluajtshme, t’i depozitojë në bankë, etj. Në një situatë të tillë lind pyetja se cilit prej bashkëshortëve do t’i përkasin këto sende apo të drejta të fituara gjatë martesës. Si do të ndahen ato në rast se përfundon martesja?

Nëpërmjet këtij punimi, synojmë t’i japim përgjigje pyetjeve të mësipërme duke u bazuar në Kodin e Familjes. Titulli i tretë i pjesës së dytë të kodit rregullon regjimin pasuror martesor mes bashkëshortëve. Nocioni i regjimit pasuror martesor përcaktohet në nenin 66 të kodit i cili përcakton se regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi dhe legjislacionit përkatës.⁶⁶

Për ndryshimin e regjimit pasuror mund të arrijmë në përfundim se në ndryshimin e një regjimi pasuror duhet që të plotësohen disa kushte që kanë të bëjnë me përmbajtjen e marrëveshjes ose kontratës me pëlqimin e bashkëshortëve, me motivim e ndryshim dhe afatin. Sipas kësaj dispozite bashkëshortorët janë të lirë të ndryshojnë tërësisht regjimin pasuror si për shembull të zavendësojnë regjimin në bashkësi me regjimin e pasurive të ndara ose kundërta.

Gjithashtu ata mund të ndrojnë pjesërisht atë. Ndryshimet e pjesëshme mund të kenë të bëjnë me administrimin e pasurisë së përbashkët në regjimin e bashkësisë ose të rikompensimin të masave të pasurisë së bashkëshortëve ose likuidimin e regjimit si p.sh parashikimi i një klauzole për ndarje të pabartë të pasurisë në regjimin e bashkësisë me kontrate.

⁶⁶ Xhensila Kadi, *Nocioni i regjimit pasuror në marrëdhëniet bashkëshortore sipas legjislacionit shqipëtarë*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ICLS 2015 – libri i apstrakteve, fq.27

Në sistemet që zbatojnë regjim pasuror të kontraktuar, bashkëshortët kanë mundësinë që regjimin pasuror që kanë zgjedhur nën kushte të caktuara me ligj ta ndryshojnë pjesërisht ose plotësisht. Bashkëshortet janë të lirë të ndryshojnë tërësisht regjimin martesor p.sh. ta zavendësojnë regjimin e pasurisë së përbashkët me regjimin pasuror p.sh. Ndryshimi i mënyrës së administrimit të pasurisë.⁶⁷

Sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve palët kanë të drejtë që të ndryshojnë ose të zgjidhin kontratën që kanë lidhur me kusht që të dyja palët të jenë dakord, mirëpo kjo rregull nuk vlenë për bashkëshortët, ata nuk kanë të drejtë që të ndryshojnë regjimin pasuror vetëm me dakordimin e vullnetit të tyre. Bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë zgjedhin ose përjashtojnë regjimin pasuror mbrenda kufijve të caktuar ligjore.⁶⁸

Afati: ndryshimi i regjimit pasuror martesor mund të realizohet vetëm pas kalimit të dy vjetëve të zbatimit të tij. Kjo duhet që bashkëshortëve për të parë funksionimin e regjimit në këtë afat kohor, duke reflektuar bashkërisht për këtë ndryshim. Edhe pse Kodi i Familjes nuk e ka parashikuar shprehimisht këtë rast në fakt në analizë të kësaj dispozite (neni 72⁶⁹/1 i Kodit të Familjes) arrijmë në përfundim se afati dy vjeçar duhet të respektohet sa herë të ndryshojë regjimi pasuror. Efekti i regjimit pasuror martesor fillon qysh nga dita e celebrimit të martesës.

Pëlqimi i bashkëshortëve: Neni 72,⁷⁰ paragrafi i parë i Kodit të Familjes kërkon që bashkëshortët të bien dakord për ndryshimin e regjimit martesor duke mos ndryshuar tërësisht apo pjesërisht atë. Vullneti i bashkëshortëve nuk duhet të jetë i vesuar. Pëlqimi i bashkëshortëve duhet të qëndroj deri në ditën kur ata nënshkruajnë marrëveshjen për ndrysimin e regjimit pasuror martesor.

Interesi i familjes: Neni 72⁷¹, paragrafi i parë i Kodit të Familjes përveç pëlqimit të bashkëshortëve dhe afati dyvjeçar si kusht për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kërkon edhe ekzistencën e interesit të familjes. Megjithatë neni 72, i Kodit të Familjes nuk e saktëson pranimin dhe pëlqimi e bashkëshortëve ata duhet të jenë të njëkohshme sipas kushteve të parashikura në nenin 69.

⁶⁷ Zendeli,Emine, *Contraction property regime of spouses*, Comperative Overview, fq.15

⁶⁸ Po aty fq.16

⁶⁹ *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014

⁷⁰ *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014

⁷¹ *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014

Nocioni i interesit të familjes: Nocioni i interesit të familjes është me përmbajtje të ndryshme pasi vlerësohet rast pas rasti. Kur bëhet fjalë për interesin e familjes çështja e parë që shtrohet është: çfarë kuptohet me familje në këtë rast? Familja, interesi i së cilës meret në konsideratë është ajo familje që ka themeluar martesë, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre. Interesi i familjes nuk është vetëm interes i një grupi. Elementi kryesor i nocionit interes i familjes ka të bëjë kryesisht me përmisimin e regjimit pasuror martesor fillestar në interes të familjes. Pra kur edhe regjimi martesor është i mirë nëse ndryshimi bëhet për përmisimin e tij, kjo konsiderohe se është në interes të familjes.⁷²

Publikimi i ndryshimit të regjimit martesor: Sipas nenit 72, paragrafi i tretë i Kodit të Familjes, ndryshimi pasuror martesor ka efekt të kundërtë të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Në mungesë të këtij shënimi bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor. Nga kjo dispozitë rezulton sa për të mbrojtur të tretët janë të detyrueshme disa rregulla për masat e publikimit.

1.4 AUTONOMIA E VULLNETIT NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE PASURORE

Në teorinë juridike si metoda të së drejtës civile zakonisht numërohen katër metoda (parime), të cilat janë të përbashkëta për tërë objektin e të drejtës civile. Këto parime të së drejtës civile janë: Barabarësia e palëve dhe barabarësia e vullneteve të tyre në raportin juridiko-civil; iniciativa e lirë e palëve në lidhjen e punëve juridiko-civile; sanksioni pasuror, dhe qarkullueshmëria e të drejtave subjektive civile. Parimi i barabarësisë së palëve dhe barabarësisë së vullneteve të tyre është parimi i parë që na bënë me dije se, palët në raportin juridiko-civil janë të barabarta dhe vullneti i tyre është i barabartë. Ky parim nënkupton se, në të drejtën civile midis palëve gjithmonë ekziston koordinimi i vullneteve të tyre, çka nuk është karakteristikë për të drejtën administrative, ku kemi subkordinimin e vullnetëve të palëve.

Iniciativa e lirë e palëve – që disa e quajnë parimi i dispozivitit nënkupton krijimin e marrëdhënies juridiko-civile e cila lind në bazë të iniciativës së lirë të palëve, respektivisht me vullnetin e lirë të palëve.

⁷² Arta Mandro – Bilalli, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjan Fullani, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, fq.330

Autonomia e lirë e vullnetit që manifestohet përmes iniciativës së lirë të palëve, nënkupton, se palët me vullnetin e vetë krijojnë ndryshojnë dhe i shuajnë të drejtat e veta subjektive. Sanksioni pasuror është parimi i tretë i të drejtës civile – nënkupton se në rastet kur nuk përmbushet raporti juridiko-civil në pajtim me vullnetet e palëve kontraktuese, atëherë si masë paraqitet sanksioni pasuror, që dmth, goditet masa pasurore e debitorit, e jo siq është në rastet tjera, personaliteti. Në të drejtën penale, si dënim ishte privimi nga liria, në të drejtën familjare do të ishte shkurorëzimi, ndërsa në të drejtën civile do të ishte përbushja e obligimit të marrë nga masa pasurore e debitorit përmes rrugës gjyqësore. Autonomia e vullnetit, i cili është i njohur edhe si dispozicion i lirë, përcakton mundësinë, që subjektet në të drejtën civile të vendosin lirshëm se në cilat dhe çfarë lloje të marrëdhënieve juridiko civile do të mbështeten duke i përcaktuar të gjitha elementet e atyre marrëdhënieve. Ky princip manifestohet në të gjitha pjesët e veçanta të së drejtës civile. Në marrëdhëniet juridiko sendore ky princip shprehet në lirinë e kryerjes së të drejtave subjektive sendore d.m.th nëse një person do të fitojë pushtet mbi një send ose jo.⁷³

Nëse bartësi e fiton, atëherë mund ti realizojë autorizimet e veta sipas dëshirës së tij. Në marrëdhëniet juridike të detyrimeve ky princip shprehet në lirinë e marrëveshjes, d.m.th lirinë e rregullimit të marrëdhënieve të detyrimit. Në të drejtën trashëgimore ky princip shprehet me lirinë e caktimit të trashëgimtarëve. Ky princip vjen në shprehje të plotë edhe te mbrojtja e të drejtave subjektive civile, për arsye se prej subjekteve të së drejtës varet që nëse në rast të shkeljes së tyre do të kërkohet mbrojtja e drejtave para organeve kompetente shtetërore. Parimi i autonomisë së vullnetit ka më tepër lëshime. Kështu, ekzistojnë marrëdhënie juridiko civile, ku subjektet, gjegjësisht njëri nga subjektet hyn në ato marrëdhënie pavarësisht vullnetit të tij. Ato janë marrëdhënie të cilat krijohen me shkaktimin e dëmit, me kompensimin e dëmit të shkaktuar, me gjetjen e sendit të huaj, kryerja punëve të huaja pa kërkesë, fitimin pa bazë dhe të gjitha marrëdhëniet e tjera që krijohen në bazë të faktit juridiko ci-vil ku vullneti i subjektit nuk merr pjesë në krijimin e tyre. Nëse e shikojmë anën tjetër të medaljes së debatit juridik për parimin rregullues së marrëdhënieve pasurore midis çifteve doemos paraqitet parimi i autonomisë së vullnetit e cila gjen fushëzbatim tek kjo çështje.

⁷³ Ana Axhievskaja, *Bazat e së Drejtës Private*, për vitin e tretë, Shkup, 2010, fq. 24

Parimi i autonomisë së vullnetit nuk është i natyrës absolute. Ekzistojnë kufizime të shumta të këtij principi. Kufizimet e këtij principi janë të pranishme në të gjitha pjesët e të drejtës civile.⁷⁴

Për shembull:

Pronari në të drejtën sendore, e realizon të drejtën e vet në përputhshmëri me natyrën dhe me destinimin e sendit, dhe në përputhshmëri me interesin shoqëror të caktuar me ligj.⁷⁵

Në të drejtën e detyrimeve pjesëmarrësit në qarkullim, i rregullojnë lirshëm marrëdhëniet e detyrimit, por nuk mundën t'i rregullojnë ato në kundërshtim me parimet e rregullimit shoqëror të caktuar me Kushtetutën, dispozitat detyruese dhe moralit të shoqërisë.⁷⁶

Në të drejtën trashëgimore, trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pjesë të trashëgimisë me të cilën trashëgimlënësi nuk ka mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e detyrueshme.⁷⁷

Kontrata martesore përfaqëson rregullin e përgjithshëm, në rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe vetëm në mungesë të një kontrate martesore do të zbatohet regjimi i bashkësisë ligjore, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.⁷⁸

Regjimi i bashkësisë është zgjedhur nga ligjvënë si regjimi më i përshtatshëm për të garantuar barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve në marrëdhënien martesore, regjim i cili zbatohet automatikisht në mungesë të një vullneti të shprehur të bashkëshortëve drejt një tjetër regjimi pasuror.⁷⁹

Autonomia e vullnetit të lirë tek bashkëshortët ka disa kufizime:

- ✓ *Kufizime të përgjithshme të përcaktuara në kod.civil.*
- ✓ *Kufizimet e veçanta që gjenden në kod. Familjar.*

⁷⁴Ana Axhievskaja, *Bazat e së Drejtës Private*, për vitin e tretë, Shkup, 2010, fq.25

⁷⁵Neni 4, paragrafi 1 *Ligji për marrëdhëniet e detyrimit*, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 18/01

⁷⁶Neni 29, paragrafi 1 nga *Ligji për trashëgimi*.

⁷⁷Neni 158, paragrafi 1, LPDTS

⁷⁸Omari, *E Drejta Familjare*, fq. 58

⁷⁹Russo, *Le convenzioni matrimoniali Ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 152.

KAPITULLI I DYTË

2. ROLI DHE RËNDËSIA E KONTRATËS MARTESORE.

Institucioni i martesës haset në të gjitha shoqëritë njerëzore të botës së hershme dhe asaj moderne, përbën një nga shtyllat mbi të cilat këto shoqëri kanë ngritur tërë ngrehinën e tyre dhe ka qenë objekti i studimit dhe i përkufizimit nga shumë shkolla fetare, filozofike, sociologjike, psikologjike, kulturore etj. Në shumë kultura është parë si një kusht i domosdoshëm për përjetësimin e gjinisë njerëzore, si një vatër e domosdoshme për rritjen dhe zhvillimin e njeriut si individ dhe person dhe në këtë kuadër edhe si bërthama e shumë shoqërive në anë të ndryshme të globit. Në mjaft fe që mbizotërojnë në planetin tonë përbën një nga çështjet më kryesore dhe të shenjta, shpeshherë tabu dhe është mbrojtur nga ana e tyre me tërë arsenalin e argumenteve teologjike dhe filozofike, në mënyrë që të ruajë tërë rëndësinë dhe shenjtërinë e saj, duke u prezervuar edhe nga legjislacionet përkatëse në ato vende, ku këto fe kanë predominuar gjatë përhapjes së tyre. Institucioni i martesës haset në të gjitha shoqëritë njerëzore të botës së hershme dhe asaj moderne, përbën një nga shtyllat mbi të cilat këto shoqëri kanë ngritur tërë ngrehinën e tyre dhe ka qenë objekti i studimit dhe i përkufizimit nga shumë shkolla fetare, filozofike, sociologjike, psikologjike, kulturore etj. Në shumë kultura është parë si një kusht i domosdoshëm për përjetësimin e gjinisë njerëzore, si një vatër e domosdoshme për rritjen dhe zhvillimin e njeriut si individ dhe person dhe në këtë kuadër edhe si bërthama e shumë shoqërive në anë të ndryshme të globit.⁸⁰

Në mjaft fe që mbizotërojnë në planetin tonë përbën një nga çështjet më kryesore dhe të shenjta, shpeshherë tabu dhe është mbrojtur nga ana e tyre me tërë arsenalin e argumenteve teologjike dhe filozofike, në mënyrë që të ruajë tërë rëndësinë dhe shenjtërinë e saj, duke u prezervuar edhe nga legjislacionet përkatëse në ato vende, ku këto fe kanë predominuar gjatë përhapjes së tyre. Nëpërmjet kontratës së martesës bashkëshortët organizojnë mjetet ekonomike të familjes së tyre përcaktojnë pasuritë që ata duhet të kenë pronësi tërësore të njërit prej tjetrit dhe pronësitë e përbashkëta.

⁸⁰ Russo, *Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia*, fq. 152.

Kontrata martesore është shumë e rëndësishme pasi që konsiderohet si një instrument ndihmës i cili lejon palët të zgjidhin në mes regjimeve martesore ose të ndryshojnë ato në përputhje me kriteret e parashikuara me ligj dhe me interes të familjes. Po ashtu mos të lëmë pa përmendur se kontrata martesore është një akt solem dhe akt kompleks.

2.1 DOMOSDOSHMËRIA E KONTRATËS MARTESORE

Kompleksiteti i familjes së sotme ka karakteristikat e një minishteti, ku gjithçka duhet të rregullohet në bazë të sistemit të kontratave. Nëse para se të lidhësh martesën, në kohën e lidhjes së saj dhe gjatë gjithë kohës së bashkëjetesës, si burrë e grua në familje dhe në raport me fëmijët nuk i bën të gjitha veprimet në bazë të legjislacionit në fuqi, nesër e kërkon të drejtën tënde me “këmbë” dhe nuk mund ta zgjidhësh dot.⁸¹

Madje, veç dëmeve që i sjell vetes mund t’u krijosh të tretëve probleme serioze. Përmes kësaj kontrate përcaktojnë statusin pasuror të familjes së tyre të ardhshme, kush do merret me administrimin e pasurisë, si do t’i ndërtojnë marrëdhëniet me personat e tretë, si do i trajtojnë dhuratat e ndryshme që do t’u vijnë në jetë, do të jenë ato të familjes apo individuale, si do të trajtohen pasuritë që u vijnë nga trashëgimia, nga krijimtaria e secilit etj. Kjo kontratë duhet të bëhet domosdoshmërisht para martesës dhe efektet e saj ligjore fillojnë ditën që bëhet celebrimi i martesës. Në rast se nuk bëhet një kontratë e tillë para martesës dhe para noterit publik, i cili ka detyrimin ligjor që ta çojë këtë kontratë në Zyrën e Gjendjes Civile, duke e bërë pjesë përbërëse të aktit që lidh martesën, bashkëshortët presupozohet se kanë zgjedhur regjimin e bashkësisë ligjore, lidhur me pasurinë bashkëshortore. Ky prezumim do të thotë se, në rast se burri ka marrë një hua apo ka një detyrim ndaj të tretëve, ky detyrim ndaj të tretëve është i përbashkët me bashkëshorten e tij. Kodi ynë i Familjes, i ndërtuar prej modelit francez, ka të parashikuara në disa nene të tij, si konkretisht hartohet një kontratë martesore, si mund të ndryshohet ajo dhe kur e si mund të ndërhyjnë personat e tretë që kanë interesa, për të mos lejuar spostimin nga detyrimet e ndryshme të njërit apo tjetrit bashkëshort, duke fiksuar në kontratë pika të tilla që i bëjnë të paekzekutueshme detyrimet pasurore që kanë ndaj tyre njëri apo tjetri

⁸¹ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi*.

bashkëshort etj. Në kushtet e ekzistencës së kontratës së martesës, kur bashkëshortët divorcohen dhe kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së tyre bashkëshortore, gjithçka është e lehtë për t’u zgjidhur, sepse në kontratë janë parashikuar me hollësi gjithçka nevojitet për një ndarje të butë e pa probleme. Martesa ‘fluturon’ shpejt ndarja e pasurisë është një fenomen që ta nxin jetë. Në momentin kur gjyqjëtari ka goditur tavolinë, zhurma e tij nuk lajmëron vetëm se ti tashmë do ti kthehesh jetës tënde beqare, por edhe se telashet nuk kanë të sosur.

2.2 PASURIA MES BASHKËSHORTEVE SIPAS RREGJIMIT PASUROR NË BASHKËSI

Pasuria bashkëshortore ka statusin e regjimeve pasurore martesor në bashkësisë ligjore e cila zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor. Ky rregjim i pasurisë bashkëshortore është i sanksionuar në Kodin e Familjes, konkretisht në nenet 73-108.

i) Bashkësia përbëhet nga:

- ✓ *Pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;*
- ✓ *Të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;*
- ✓ *Frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.*

Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.⁸²

⁸² Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi*.

ii) Pasuria e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare

Pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve dhe shtesat e prodhimit të saj janë objekt i bashkëpronësisë vetëm nëse ekzistojnë si të tilla në çastin e mbarimit të martesës. Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.

iii) Pasuria vetjake

Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

- ✓ *Pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt se cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;*
- ✓ *Pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose lekut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;*
- ✓ *Pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake;*
- ✓ *Mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;*
- ✓ *Pasuria e fituar nga shpërblimi i demit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;*
- ✓ *Pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura;*
- ✓ *Shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.⁸³*

Bashkësia mund të përfitojë kompensim, pas mbarimit të saj, për të ardhurat dhe pasuritë që bashkëshorti ka neglizhuar të marrë ose për ato që ai ka shpenzuar në keqbesim. Kërkesa për kompensim duhet të paraqitet nga bashkëshorti i interesuar para mbarimit të procedurës të ndarjes së pasurisë.

⁸³ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi.*

iv) E drejta e kompensimit

Pasuria e fituar në shkëmbim të një pasurie, e cila i përkiste individualisht njërit prej bashkëshortëve, është pasuri vetjake, me përjashtim të kompensimit që i bëhet bashkësisë ose e kundërta, kur nga shkëmbimi rezulton tek diferenca. Nëse diferenca në ngarkim të bashkësisë është me e madhe se vlera e pasurisë vetjake të tjetërsuar, pasuria e fituar në këtë shkëmbim i përket bashkësisë, përveç kompensimit në favor të pasurisë vetjake të bashkëshortit. Të ardhurat e përfituara, si pasojë e një ankandi ose forme tjetër, të një pasurie të paluajtshme, ku njeri nga bashkëshortët është bashkëpronar në pjesë të pandarë, nuk përbën pasuri të fituar gjatë martesës. Me përjashtim të kompensimit që duhet t’i bëhet bashkësisë për shpenzimin që ajo ka bërë.⁸⁴

v) Detyrimet mbi bashkësinë

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi:

- ✓ *Për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë*
- ✓ *Për të gjitha shpenzimet e administrimit të pasurisë së përbashkët;*
- ✓ *Për të gjitha shpenzimet për mbajtjen e familjes dhe për çdo detyrim të kontraktuar nga bashkëshortët, qoftë dhe veçmas, që është në interes të familjes;*
- ✓ *Për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vetjake në këtë Kod.*

Detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës ose që rëndojnë trashëgimitë dhe dhurimet që fitojnë gjatë martesës mbeten detyrime vetjake. Kreditoret e bashkëshortit, në rastin e nenit 82, mund t’i kërkojnë pagesat e tyre fillimisht mbi pasurinë vetjake dhe të ardhurat e bashkëshortit debitor. Ata mund të kërkojnë dhe vënien sekuestro mbi pasurinë e bashkësisë, atëherë kur pasuritë e luajtshme që i përkasin debitorit të tyre datën e lidhjes së martesës ose që i fitojnë me trashëgimi ose me dhurim janë përzier me pasurinë në bashkësi dhe nuk mund të identifikohen, sipas këtij Kodi.

⁸⁴ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi*.

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në gjysmën e vlerës së saj, kundrejt kreditorëve vetjake të çdo bashkëshorti, kur pasuria vetjake e tij nuk mjafton për përmbushjen e:

- ✓ *Detyrimeve qe ai ka marrë përsipër vetëm për administrimin e pasurisë në bashkësi, jashtë kufijve të tagrave të tij të administrimit;*
- ✓ *Detyrimeve të tij vet, cilido qoftë çasti i lindjes se tyre.*

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet, nëse ka pasur mashtrim nga bashkëshorti debitor dhe keqbesim nga kreditori. Në rast se detyrimi vetjak i njërit bashkëshort është shlyer nga bashkësia, ai detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë. Të ardhurat vetjake të një bashkëshorti nuk mund të preken nga kreditorët e bashkëshortit tjetër, vetëm nëse detyrimi ka qenë i kontraktuar për mirëmbajtjen e banesës dhe të familjes.⁸⁵

vi) Detyrimet e kontraktuara veçmas nga bashkëshortët

Në rastin kur detyrimi është kontraktuar në interesin vetjak të njërit prej bashkëshortëve dhe ai është shlyer nga pasuria në bashkësi, bashkëshorti përfitues detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë. Në rast se nga pasuria në bashkësi janë paguar gjopa ose dëmshpërblime, për të cilat është detyruar njeri prej bashkëshortëve për shkak të një dënimi penal ose administrativ, ai detyrohet të kompensojë pasurinë në bashkësi. Bashkësia ka të drejtën për kompensim nëse detyrimi që bashkësia ka shlyer ishte kontraktuar nga njeri prej bashkëshortëve në kundërshtim me detyrimet që i imponon martesë.

vii) Detyrimet solidare të bashkëshortëve me pasurinë në bashkësi

Kur një detyrim vjen në bashkësi për shkak të njërit bashkëshort, ai nuk mund të kërkohet mbi pasuritë vetjake të bashkëshortit tjetër. Nëse ka detyrime solidare të dy bashkëshortëve, ai mund të kërkohet mbi pasurinë në bashkësi.

⁸⁵ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi.*

viii) Administrimi i bashkësisë

Secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi. Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi / Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve.

xix) Administrimi nga një bashkëshort

Në rast largësie ose pengese tjetër të njërit bashkëshort dhe në mungesë të prokurës ose autorizimit të gjykatës, bashkëshorti tjetër mund të kryejë veprimet që janë të nevojshme edhe në rastin kur kërkohet pëlqimi i të dy bashkëshortëve, sipas nenit 90 të këtij Kodi.

x) Refuzimi i pëlqimit

Nëse njeri prej bashkëshortëve refuzon të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi të administrimit të jashtëzakonshëm ose për veprime të tjera, për të cilat kërkohet pëlqimi, bashkëshorti tjetër mund t’i drejtohet gjykatës për të marre autorizimin. Gjykata vendos dhënien e autorizimit kur kryerja e veprimit është e nevojshme për interesa të familjes ose të veprimtarisë tregtare që bën pjesë në bashkësi.⁸⁶

xi) Zëvendësimi në administrim

Nëse njeri nga bashkëshortët, për një kohë të vazhdueshme, ndodhet jashtë gjendjes për të shprehur vullnetin e tij, ose nëse administrimi i bashkësisë nga ana e tij dëshmon për paaftësi ose keqbesim, bashkëshorti tjetër mund t’i kërkojë gjykatës të zëvendësojë atë në ushtrimin e të drejtave të tij. Bashkëshorti i privuar nga të drejtat e administrimit të bashkësisë mund t’i kërkojë gjykatës rikthimin e tyre, nëse provon se janë zhdukur shkaqet e përjashtimit të tij nga administrimi.

⁸⁶ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi*.

xii) Tejkalimi i të drejtave

Nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohet nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim: Kjo padi mund të ngrihet brenda 1 viti nga data e marrjes dijeni për veprimin dhe në çdo rast, jo më vonë se 1 vit nga mbarimi i bashkësisë.

xiii) Administrimi i pasurisë vetjake të bashkëshortit

Secili bashkëshort ka të drejtë të administrojë dhe të disponojë lirisht pasuritë vetjake. Nëse gjatë martesës njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij vetjake, zbatohen rregullat e përfaqësimit. Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë vetjake të tjetrit, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një akt përfaqësimi në heshtje, që mbulon veprimet e administrimit dhe të përdorimit, me përjashtim të tagrit të disponimit. Në këtë rast, ai përgjigjet kundrejt bashkëshortit tjetër me cilësinë e përfaqësuesit dhe nëse është rasti detyrohet të dorëzojë vetëm frytet që ekzistojnë, duke mos u përgjigjur për atë që janë konsumuar. Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit, administron pasurinë e tij vet dhe kryen veprime lidhur me të përgjigjet për dënim e shkaktuar dhe për frytet që duhet të ishin marrë. Në këtë rast, bashkëshorti i dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi për anulimin e veprimit të kryer sipas kritereve të përcaktuara në nenin 94 të këtij Kodi.

xiv) Mbarimi i bashkësisë

Bashkësia mbaron me:

- ✓ *Vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës;*
- ✓ *Pjesëtimin e pasurive;*
- ✓ *Ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e bashkësisë.⁸⁷*

⁸⁷ Huazuar për mendim nga Avokat Mentor Bimi, *Pasuria mes bashkëshortëve sipas regjimit pasuror në bashkësi.*

xv) Ndalimi i pjesëtimit

Pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshjeje të bashkëshortëve. Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohet në gjykatë në rast paaftësie dhe administrimit të keq të njërit prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë prej tij ve në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes, ose kur njeri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi. Ndarja e pasurisë mund të kërkohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga përfaqësuesi i tij ligjor. Kreditorët e njërit bashkëshort nuk mund të kërkojnë vete ndarjen e pasurisë. Vendimi i gjykatës për ndarjen ka fuqi që nga data kur është paraqitur kërkesa dhe i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive martesore të ndara, të parashikuar në këtë Kod. Kur procedura për pjesëtimin e pasurisë ka filluar, kreditorët mund të kërkojnë të njihen me kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga bashkëshortët, si dhe të ndërhyjnë në seancën gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

a) Regjimi pasuror ligjor – bashkësia e pasurisë së krijuar në martesë

Regjimi i bashkësisë së pasurisë së krijuar në martesë (*communaute reduite aux acquets*), është regjim ligjor i cili u vendos me reformat e sjelluara nga Ligji për reformimin e regjimit pasuror të bashkëshortëve të vitit 1965. Ai zbatohet atëherë kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë ose kur për këtë regjim janë përcaktuar shprehimisht. Kjo, për arsye se në të drejtën franceze ky regjim është edhe regjim ligjor por edhe regjim subsidiary i cili mund të kontraktohet nga ana e bashkëshortëve. Bashkësia e pasurisë së krijuar formohet nga të mirat e krijuara bashkërisht nga bashkëshortët dhe të mirat e krijuara në mënyrë të ndarë përgjatë kohëzgjatjes së martesës. Sipas regjimit ligjor të bashkësisë së pasurisë së krijuar, në çdo martesë egzistojnë tri masa pasurore: pasuria e veçantë e gruas, pasuria e veçantë e burrit dhe bashkësia e pasurisë së krijuar.

Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohet marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë njihet si regjim pasuror i bashkëshortëve.⁸⁸

2.3 ADMINISTRIMI I PËRBASHKËT

Bashkëshortëve u takon në mënyrë të barabartë, pushteti i administrimit të pasurive të bashkësisë dhe përfaqësimi në gjykim. Sasia e pasurisë së përbashkët duhet të kontribuojë, nëpërmjet fryteve civile dhe natyrore të prodhuara nga pasuritë që e përbëjnë për përmbushjen e nevojave të familjes; ajo sasi kuptohet kërkon një mori aktesh administratuese si për qëllim të ruajtjes poashtu edhe për qëllim të shtimit. Këto akte mund të përmbushen nga një ë trete në bazë të një prokure special që i është lëshuar, shprehimisht dhe me marrëveshje nga bashkëshortët por janë vetë bashkëshortët që kujdesen për administrimin.⁸⁹

Bashkëshortët mund të jenë të pa motivuar për të lidhur kontratën martesore pasi si e para konsiderojnë se pasuria të cilën e kanë në momentin e lidhjes së martesës është mbrojtur me vendosjen e saj në proneësi të veçantë të bashkëshortit, që do të thotë se çdonjëri prej tyre ruan të drejtën e administrimit dhe disponimit të plotë në pasurinë që ka sjellur në martesë dhe atë që e fiton nëpërmjet të punëve juridike pa shpërblim (dhuratës, testamentit, legut) gjatë kohëzgjatjes së martesës.⁹⁰

Si rregul i përgjithshëm është gjithmonë i mundshëm lëshimi ndaj bashkëshortit tjetër të një prokure për administrimin e pasurisë së përbashkët; bëhet fjalë për prokurë speciale d.m.th në lidhje e akte të veçanta dhe gjithmonë të revokueshme. Rrethana të veçanta siç mund të jetë pengesa për arsye shëndetësore të një bashkëshorti, mund të sjellin lëshimin e prokurës së përgjithshme. Pra bashkëshortëve u takon në mënyrë të barabartë, pushteti i administrimit të pasurive të bashkësisë dhe përfaqësimi në gjykim.⁹¹

⁸⁸ Zendeli, Emine, *Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkohore të bashkëshortëve*, Tetovë, 2017, fq.6

⁸⁹ Bonilini Giovanni, *Manuali i së drejtës familjare*, Tiranë, 2005, fq.102

⁹⁰ Zendeli, Emine, *Contraction property regime of spouses*, Comparative Overview, fq.4

⁹¹ Po aty fq.4

Aktet e një administrimi të zakonshëm në të vërtetë, mund të kryhen veçmas nga secili prej bashkëshortëve ndërsa ato të një administrimi të jashtëzakonshëm bashkëshortët duhet ti paraqesin së bashku. Mund të ndodh që akti të paraqitet vetëm nga një prej bashkëshortëve por me pëlqimin e tjetrit. Ndryshimi mes akteve të një administrimi të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm mund të modelohet në atë që është në fuqi, përkasin administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm mund të modelohet në atë që është në fuqi: i përkasin administrimit të zakonshëm aktet që synojnë ruajtjen e pasurive dhe fitimin e të ardhurave që rrjedhin prej tyre edhe në lidhje me nevojat e familjes i përkasin një administrimi të jashtëzakonshëm ato që ndryshojnë strukturën e atyre pasurive si psh. Aktet e tjetërsimit (shtija, shkëmbimi, dhurata, etj).

Kryerja nga ana e një bashkëshorti, e një akti për të cilin ligji kërkon domosdoshmërisht pëlqimin e tjetrit sjell mundësinë e kërkesës së anulimit nëse bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme apo të luajtshme të regjistruara norma nuk kërkon ndër të tjera që akti të rrjedh një dem. Kundërshtimi është përfshirë por nëse bashkëshorti tjetër e ka borë të vlefshëm. Veprimi i nënshtrohet afatit që është për pjesën më të madhe kusht humbje e së drejtës, viti dhe atë duke filluar nga data në të cilin bashkëshorti pëlqimi i të cilit ishte i nevojshëm. Ka marë djepi për aktin dhe në çdo rast nga data e transkriptimit të atij akti atëherë kur nuk kemi transkriptim dhe bashkëshorti megjithëse nuk ka patur djepi për aktin para mbarimit të bashkësisë, veprimi nuk mund të kërkohet përtej një viti nga mbarimi i bashkësisë.⁹² Aktet e administrimit të pasurive të përbashkëta së fundmi mund të kryhen në mënyrë ekskluzive nga një bashkëshortë atëherë kur tjetri është përjashtuar nga një prej shkaqeve. Rastet e përjashtimit janë: mosha e mitur, meqë i hiqet bashkëshortit në moshe të mitur edhe pushteti i kryerjes së akteve të administrimit të zakonshëm. Përjashtimi mund të deklarohet me kërkesë të tij, në pushtete e administrimit nëse nuk ekzistojnë me motivet që justifikuan përjashtimin.⁹³

Bashkëshorti i ndaluar gjersa të ekzistojë gjendja e ndalimit është përjashtuar nga e drejta e administrimit, ndalimi mund të jetë shkak i ndarjes gjyqësore të pasurive dhe në rast të revokimit të ndalimit kemi rikthimin e menjëhershëm të pushteteve.⁹⁴

⁹² Bonilini Giovanni, *Manuali i së drejtës familjare*, Tiranë, 2005, fq.102

⁹³ Po aty fq.103

⁹⁴ Po aty fq.103

Pasuria e veçantë e bashkëshortëve është ajo pasuri që bashkëshortët e kanë krijuar para lidhjes së martesës ose gjatë kohëzgjatjes së martesës por në bazë të kohëzgjatjes së martesës por, në bazë të ndonjë kërkesë ose punë juridike të lidhur para martese, në bazë të suksedimit, donacionit dhe legut. Për pasuri të veçantë, bëhet fjale ehe në rastet kur të mirat pasurore të dhuruara nga prindërit, ose personat e tjerë i dedikohen vetëm njërit nga bashkëshortët. Në pasurinë e veçantë të bashkëshortëve për nga vetë natyra e tyre, bëjnë pjesë edhe sendte për përdorim ekskluzivisht personal edhe atëherë kur këto janë fituar me mjete nga pasuria e krijuar në martesë. Mjetet e fituara në bazë të kompenzimit të dëmit pensionit etj, të njërit bashkëshort bëjnë pjesë në pasurinë e veçantë të njërit bashkëshort, gjithashtu bëjnë pjesë në pasurinë e veçantë të bashkëshortit që ushtron këtë veprimtari. Nëse vlera e tyre është shumë e madhe, në krahasim me vlerën e pasurisë së krijuar dhe standarteve në mjedisin e caktuar atëherë kjo vlerë do të llogaritet në pasurinë e përbashkët. Sendet që përbëjnë pasurinë e veçantë të bashkëshortëve janë në pronësi të plotë të tyre.⁹⁵ Prandaj edhe secili prej bashkëshortëve pavarësisht administron dhe disponon me pasurinë e tyre. Bashkëshorti ka të drejtë që me anë të kontratës së autorizimit ti besojë bashkëshortit tjetër administrimin e veçantë të tij. Por, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton edhe autorizimin e disponimit me pasuri të veçantë të bashkëshortit tjetër. Administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët, bashkëshortët e bëjnë bashkërisht dhe me marrëveshje. Ata merren vesh paraprakisht për veprimet faktike dhe juridike që duhet të ndërmerren me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pasurisë së përbashkët si dhe lidhur me shtimin e vlerës së asaj pasurie, respektivisht, veprimet faktike dhe juridike lidhur me administrimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm të pasurisë. Me administrimin e rregullt të pasurisë nënkuptojmë veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me; ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët, riparimin e sendit të përbashkët, punimin e rregullt të tokës, mbledhjen e frutave). Nëse veprimet faktiket dhe juridike që duhet të ndërmerren lidhur me pasurinë e përbashkët kalojnë kufijtë e asaj që quhet administrim i pasurisë bëhet fjalë për të ashtuquajturën administrim i jashtëzakonshëm me pasurinë e përbashkët. Asnjëri prej bashkëshortëve nuk kanë të drejtë që këto veprime ti ndërmerren pavarësisht pa pasur pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Pra kur është fjala për administrimin të jashtëzakonshëm me pasurinë e përbashkët, psh bartja e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmëri bashkëshorti duhet të merr pëlqimin e bashkëshortit tjetër.⁹⁶

⁹⁵ Bonilini Giovanni, *Manuali i së drejtës familjare*, Tiranë, 2005, fq.106

⁹⁶ Zendeli, Emine, *Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve*, Tetovë, 2017, fq.12

KAPITULLI I TRETË

3.1 LËNDA E HULUMTIMIT

Lëndë e këtij hulumtimi do të jetë analiza e normave juridike që rregullojnë të drejtën e martesës dhe të drejtat e bashkëshortëve në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë. Hulumtimi im do të përfshijë kontratën martesore si akt juridik dhe zbatimin e saj se sa ajo është e rëndësishme të zbatohet në vendin tonë dhe krahasimi me vendet e jashtme. Martesa është një ndër institucionet e lashta e gjithësi më i rëndësishmi shoqëror dhe juridik, është një lidhje midis një burri e një gruaje që kanë zotsinë e veprimit. Martesa si një bashkësi ligjore mbështet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjen e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok. Në këtë studim do të përqipem që të shpjegoj rëndësinë e kontrates martesore për bashkëshortët në të drejtën familjare dhe jo vetëm, do të analizoj normat ligjore të pjesës së domosdoshme të kontrates martesore në të drejtën familjare, si bëhet përlllogaritja e kontratës martesore, cilat sende nuk merren parasysh me rastin e përlllogaritjes së kësaj pjese, rastet e cënimit në rast të shkurorizimit, të drejtat e bashkëshortëve që të kërkojnë të drejtat e tyre që janë të parapara me kontratën martesore. Në kontekst të përcaktimit të fatit juridik të kësaj pjesë të garantuar me ligj në mënyrë të detajuar do të analizoj normat ligjore të shteteve të huaja dhe krahasimin e tyre me vendin tonë. Kontrata martesore përfaqëson veprimin juridik me anë të së cilës dy persona që do të lidhin martesë, krijojnë regjimin martesor pasuror, ndryshojnë ose shuajnë regjimin martesor pasuror që ka ekzistuar që nga lidhja e martesës.

Kontrata martesore, është një nga kategoritë me kontraverze të së drejtës familjare si edhe të së drejtës në përgjithësi. Dilema lidhur me mundësinë e përfshirjes së kontratës martesore në legjislacionin pozitiv është një nga pyetjet më të rëndësishme që shtrohet me rastin e reformimit të së drejtës familjare në Republikën e Maqedonisë. Kontrata martesore kundërshtohet nga një numër i madh autorësh, të cilët konsiderojnë se ajo nuk i përgjigjet natyrës juridike të martesës, në anën tjetër egziston një grup tjetër autorësh, të cilët përkrahin kontratën martesore si një mundësi për deklarimin e lirë të vullnetit të bashkëshortëve. Në kuptim të gjerë të fjalës, kontrata martesore është instrument për avansimin e pozitës së përgjithshme juridike të bashkëshortëve, sepse në këtë drejtim bashkëshortët kanë mundësinë të negociojnë lidhur me pozitën juridike-pasurore të tyre duke pranuar atë modalitet të regjimit të kontraktuar që i përgjigjet specifikave të

situates reale. Si çdo kategori e veprimeve të vullnetshme edhe kontrata martesore duhet të përmbush kushtet themelore për ekzistencën dhe vlefshmërinë e saj. Këto kushte janë: Pëlqimi i bashkëshortëve; Shkaku i ligjshëm mbi të cilin mbështetet detyrimi kontraktor; Objekti i kontratës martesore; Forma e kërkuar nga ligji për deklarimin e pëlqimit të bashkëshortëve.

Kontrata martesore është një akt juridik kompleks që parasëgjithash ka për qëllim të fiksoje statusin financiar të ekonomisë së ardhshme të familjes, respektivisht të pozitës juridikopasurore të bashkëshortëve në martesë. Me anë të kontrates martesore shprehet liria e bashkëshortëve për t’iu referuar njërit nga modelet që ofron ligji në dispozicion të tyre. Por, në kontratën martesore bashkëshortët mund të parashohin edhe kushte tjera, që nuk janë në kundërshtim me ligjin. Në interes të studimit komparativ të këtij instituti do të bëhet krahasimi i sistemit ligjor të Republikës së Maqedonisë me sistemet ligjore të shteteve në rajon veçanërisht me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.

3.2 QËLLIMET E HULUMTIMIT

Si qëllim kryesor i të bërit të një hulumtimi të tillë është studimi dhe analizimi i normave juridike, në këtë rast normave ligjore mbi pjesën e kontrates martesore. Me qëllim të kuptimit dhe njohjes më të mirë të normave ligjore të cilat rregullojnë të drejtën familjare, sa i përket kontrates martesore si domosdoshmeri apo realitet, është e nevojshme që të definohet roli dhe rëndësia e bashkëshortëve nëpërmjet kontratës martesore. Qëllimi tjetër i këtij hulumtimi është që të studioj dhe analizoj praktikën e gjykatësve dhe të noterëve gjatë hapjes së procedurës së shkurorizimit në shtetet e huaja, duke marrë të dhëna statistikore dhe duke analizuar se sa është e nevojshme edhe në vendin tonë kjo kontratë. Realizimi i qëllimit të këtij punimi do të mundësohet përmes shfrytëzimit të metodave të ndryshme si ato: normative, dogmatike, zakonore, sociologjike, komparative, historike dhe metodave tjera.

3.3 HIPOTEZAT

1. *Roli dhe rëndësia e kontrates martesore?*
2. *A është kontrata martesore njëra nga të drejtat me të rëndësishme të bashkëshortëve?*
3. *Deri në çfarë mase është e domosdoshme kontrata martesore?*
4. *Çfarë garancie paraqet kontrata martesore për bashkëshortët?*
5. *A duhet të zbatohet kjo llojë kontratë në vendin tonë dhe pse?*

3.4 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Këtë punim e kam mbështetur tek hipotezat e përmendura më lartë. Me qëllim të vërtetimit të hipotezave të tilla dhe të konkluzioneve që do të nxjerr në përfundim të punimit, do të shfrytëzoj disa metoda me të cilat do të realizoj qëllimet e theksuara në këtë punim. Si metoda të tilla do të përdor: metodën teorike dhe atë empirike, nëpërmjet këtyre metodave do të analizohen rregullat juridike qoftë të vendit apo të huaja, pastaj gjithashtu do të analizohet edhe zhvillimi i ligjeve juridike me të cilat rregullohet kontrata martesore në të drejtën familjare si domosdoshmëri apo realitet. Gjithashtu do të nxirren edhe pikat e përbashkëta dhe ato dalluese nga analiza e detajuar si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në shtetet tjera. Përveç kësaj nëpërmjet këtyre metodave punimin tim do ta kurorëzoj edhe me disa të dhëna të cilat do të ndihmojnë që të shohim se si është gjëndja në vendin tonë dhe në vendet e jashtme.

A: Si metodë teorike do të përdor:

1. METODËN NORMATIVE: si një ndër metodat më të rëndësishme e sidomos kur kemi të bëjmë me analizën e procedurave gjyqësore, me ç’rast do të përdoret për analizat e rregullave pozitive juridike të vendit dhe të huaja.

2. METODËN KOMPARATIVE: e cila do të aplikohet me qëllim të studimit më të mirë të kontrates martesore të disa shteteve të huaja. Gjithashtu këtë metodë do ta përdor më qëllim të studimit sa më të mirë të rregullave juridike si të vendit ashtu dhe të huaja me ç’rast do të mundohem të nxjerrë pikat pozitive, negative si dhe ato të përbashkta dhe dalluese në mes tyre.

3. METODËN HISTORIKE: si metodë e pashmangshme e cila përdoret në shumë punime të ndryshme shkencore, gjithashtu edhe në këtë punim kjo metodë do të zërë vend të rëndësishëm gjatë analizave dhe studimit të kontrates martesore që nga kohrat më të hershme e deri në ditët e sotëshme në RM dhe në shtetet e huaja.

4. METODËN E DEDUKSIONIT: do të përdoret me qëllim që nëpërmjet kësaj metode të arrijë deri në konstatime të sakta. Pra, me anë të kësaj metode, nga konstatime të përgjithshme do të mundem të arrij në konstatime konkrete. Përveç metodës së deduksionit do të përdor edhe metodën analoge të saj metodën e induksionit nëpërmjet së cilës nga konstatime konkrete do të mundem të nxjerr konstatime të përgjithshme.

B: Si metoda empirike do të përdor:

1. METODËN STATISTIKORE: të cilën do ta përdor me qëllim që të përfitoj një pasqyrim sa më të mirë të gjendjes sot në vendin tonë dhe në vendet e huaja duke bërë hulumtime dhe krahasime mbi kështje.

2. METODA E ANALIZËS SË PËRMBAJTJES: të akteve juridike si dhe të aktvendimeve të ndryshme si të vendit ashtu dhe të huaja, si dhe të materialeve dhe literaturave tjera të ndryshme, të njëjtat si të vendit ashtu dhe të huaja. Me anë të kësaj metode do të arrijmë të kuptojmë dhe të mësojmë shkaqet, arsyet dhe rëndësinë e sjelljes dhe ekzistimit së tyre dhe pasojat juridike të sjelljes dhe ekzistimit të tyre

3.5 RËNDËSIA E PUNIMIT

Si rezultat i procesit të tranzicionit i cili sot është prezent në çdo sferë të sistemitit juridik dhe ekonomik shoqëror të shumë vendeve të botës në zhvillim , ashtu edhe të jetës sociale dhe ekonomike të Republikës së Maqedonisë ka ndikuar në përshpejtimin e procesit të përsosjes të institucioneve juridike në përgjithësi dhe të drejtës familjare në veçanti. Ky proces në zhvillim i përsosjes nuk ka tendencë të ndaloj. Për atë shkak risit që paraqiten në çdo institucion juridik të çdo sistemi juridik pa marrë parasysh zhvillimin e tij, e shoh si të domosdoshme realizimin e hulumtimit të këtillë me qëllim të përsosjes sa më të mirë të institucioneve juridike dhe në këtë rast edhe të pjesës së kontrates martesore si një institut që nuk ekziston në ligjin e familjes të RM-së. Pasi që tezën duhet ta arsyetoj se përse e kam zgjedhur, e pashmangshme është që të mos tregoj edhe rëndësinë e këtij hulumtimi sidomos për sistemin tonë juridik. E shoh të arsyeshme bërijen e një punimi të tillë hulumtues pasi që kontrata martesore luan rol të rëndësishëm si në sistemin juridik ashtu edhe në jetën shoqërore dhe sociale. Punimi i kësaj teze përveç që ka rëndësi teorike gjithashtu ka edhe rëndësi praktike, dhe për atë shkak meriton që të jetë lëndë e analizës në punimin tim. Pra me këtë punim do të mundohem që të shpjegoj edhe rëndësinë praktike të kësaj teze gjatë përpilimit të kontratës martesore.

3.6 ASPEKTE KRAHASUESE

3.6.1 REGJIMI PASUROR I BASHKËSHORTËVE NË KORNIZËN NORMATIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Përveç regjimit pasuror ligjor, si regjim i detyrueshëm në të drejtën komperative (Francë, Austri, Gjermani, Zvicër, Kroaci, Shqipëri, Sërbi etj), është present edhe regjimi i kontraktuar ndërmjet bashkëshortëve. Sipas këtij regjimi i cili po afirmohet gjithnjë e më shumë, bashkëshortëve u jepet mundësia që marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre t'i rregullojnë në mënyrë në të cilën e përcaktojnë vetë me marrëveshje. Regjimi i kontraktuar pasuror i bashkëshortëve u jep të drejtë bashkëshortëve që të lidhin kontratë martesore, me të cilën do të përcaktojnë pozitën e tyre juridike- pasurore ndërmjet tyre t'i rregullojnë në mënyrën të cilën e përcaktojnë vetë me marrëveshje. Regjimi i kontraktuar pasuror i bashkëshortëve, u jep të drejtë bashkëshortëve që të lidhin kontratë martesore me të cilën do të përcaktojnë pozitën e tyre juridike- pasurore në martesë. Më anë të kontratës martesore bashkëshortët deklarojnë vullnetin e tyre të lirë lidhur me marrëdhëniet pasurore të tyre, respektivisht evitojnë zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet pasurore të tyre. Mundësia e shmangies të zvatimit të regjimit pasuror ligjor mund të mos jetë me interes të bashkëshortëve pasi mund të pretendohet se kjo shmangie e bart esencën e marrëdhënieve bashkëshortore nga interes personale në ato pasurore më këtë sikur i paraprinë pushimit të martesës. Bashkëshortët mund të jenë të pa motivuar për të lidhur kontratë martesore në radhë të parë pasi konsiderojnë se pasuira të cilën e kanë në momentin e lidhjes së martesës është mbrojtur me vendosjen e saj në pronësin të veçantë të bashkëshortit që do të thotë se secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit dhe disponimit të plotë me të. ndërsa, sa i përket pasurisë së krijuar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore në përgjithësi është pranuar qëndrimi se si shprehje e lidhjes ekonomike në familje do tju takojë të dy bashkëshortëve. Megjithatë është gjithnjë e më i madh numri i qytetarëve që zhvillojnë veprimtari me efekte të larta financiare së këndejmi kanë edhe të ardhura të mëdha dhe do të ishin të interesuar që marrëdhëniet e tyre pasurore ti rregullojnë ndryshe nga ajo që e parashëh regjimi imperative ligjor, para ose pas lidhjes së martesës.

Mundësia e kontraktimit të marrëdhënies pasurore p.sh në të drejtën kroate ka gjetur zbatim të gjërë si në mënyrën e rregullimit të marrëdhënies pasurore të bashkëshortëve para shkurorëzimit, të bashkëshortëve që kanë ruajtur aftësinë e komunikimit ndërmjet tyre edhe atë si zgjidhje e pranueshme për të evituar procedurën ligjore.⁹⁷

Mirëpo jo gjithmonë vehen në dukje prioritetet e kontratës martesore. Në disa mjedise shoqërore kontrata martesore ende nuk shihet me optimizim (rasti në RM). Kështu sipas disa mndimeve kontrata martesore do të hidhte një vështrim të rim bi martesën martës si bashkësi ekskluzivisht materiale. Mardhëniet pasurore të bashkëshortëve në Republikën e Maqedonisë janë rregulluar me dispozita familjare imperative, të përmbajtura në Ligjin për martesën 1946 dhe ligjin për martesën të vitit 1973. Si regjim të vetëm për rregullimin e marrëdhënies pasurore të bashkëshortëve këto ligje kanë proklamuar regjimin ligjor të pasurisë së përbashkët dhe pasurisë së veçantë të bashkëshortëve. Një zgjidhje e këtillë ligjore ka qenë e frymëzuar nga ideja se regjimi i pasurisë së përbashkët siguron barazinë në mes bashkëshortëve dhe eviton varshmerinë ekonomike ndërmjet tyre. Pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 dhe ndryshimeve në sistemin juridik, ekonomik dhe asaj politik, ajo pranoi modelimin e ekonomisë së tregut. Si rezultat i këtij përcaktimi pasuan edhe ndryshimet radikale në sistemin pronësor në përgjithësi. Duke pasur parasysh faktin se liria e kontraktimit paraqet njerin prej parimeve themelore të ekonomisë bashkëkohore të tregut, ky parim gjithashtu pritej të reflektehej edhe në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, megjithatë kjo aspirate nuk u realizua as nga Ligji i Familjes (1992) i cili edhe pse u soll një vit pas përvetësimit nuk solli ndonjë risi, ashtu që edhe më tutje bashkëshortët mbeten të nënshtruar brenda kornizave të regjimit pasuror ligjor.

⁹⁷ Zendeli, Emine, Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohore të bashkëshortëve, Tetovë, 2017, fq.16

3.7 BASHKËSIA ME KONTRATË SIPAS KODIT TË FAMILJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

Instituti i bashkësisë me kontratë është i paraqitur, nga disa interpretues, si bashkësi ligjore e modifikuar në disa profile, do të thotë: bashkëshortët kanë një anatomi të kufizuar në shmangie të reagimit ligjor; ndërsa, nga të tjerë, si regjim i vërtetë i pasurisë alternative me bashkësinë ligjore, prapë se prapë pa lëvizur parimet që regulli juridik si të pëvitetshëm.⁹⁸

Zgjidhja e bashkësive me kontratë vjen si pasojë e verifikimit të të njëjtave shkaqe të parashikuara për zgjedhjen e bashkësisë ligjore, por pranohet efektshmëria e klauzolave të pashmangshme, që synojnë si përjashtimin e verimit të disave shkaqeve për zgjedhjen të parashikuara nga ligji- si, për shembull, veçimi personal i bashkëshortëve, po ashtu për të përfshirë shkaqe jo të parashikuara.⁹⁹Sipas Kodit të Familjes së Shqipërisë, bashkëshortët, në kontratën e martesës mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore me marrëveshje, e cila nuk duhet t’vi në kundërshtim me ato dispozita të Kodit që parashikojnë te drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve që rrjedhin nga martesë. Në kontratën e martesës, bashkëshortët mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore dhe të bien në dakord që :

- ✓ *Bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës;*
- ✓ *Të ndryshojnë rregullat lidhur me administrimin;*
- ✓ *Të mos kenë pjesë të barabarta;*
- ✓ *Ndërmjet bashkëshortëve të ketë bashkësi universale.*

Në regjimin e bashkësisë me kontratë, rregullat e bashkësisë ligjore mbeten te zbatueshme për pikat që janë objekt i kontratës së martesës ndërmjet palëve, por në rastin e bashkësisë me kontratë mbeten pasuri vetjake dhe nuk mund të përfshihen në bashkësi pasuritë e përdorimit vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesorë të pasurive vetjake, mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç

⁹⁸ Bonilini Giovanni, *Manual i së drejtës familjare*, Tiranë, 2005, fq.110-111

⁹⁹ Po aty fq,112

atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare dhe pasuritë e fituara nga shpërblimi i dëmit vetjak¹⁰⁰Kodi parashikon administrimin e pasurisë nga bashkëshortët. Sipas tij, nëse bashkëshortët bien dakord që të administrojnë së bashku pasurinë në bashkësi, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të dy bashkëshorteve dhe përmbajnë detyrimin solidar të tyre. Dhe nëse në bashkësinë ligjore, pjesët e bashkëshortëve në bashkësi janë të barabarta, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe për interesa të fëmijëve kur kemi zgjidhje mund të bien dakord të caktojë pjesë të pabarabarta për pasurinë në bashkësi. Në këtë rast bashkëshortët ose trashëgimtarët e tyre i përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë në bashkësi ose që kanë përfituar nga bashkësia. Çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme.

3.8 KONTRATA MARTESORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

E drejta e pronës - është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, pronën që të përket, brenda kufijve të caktuar nga ligji”. Të gëzosh sendin apo pronën do të thotë ta përdorësh dhe ta shfrytëzosh vet atë, ose ta japësh në përdorim të tjerëve. Prona mund t’u jepet të tjerëve me qira me qëllimin për të nxjerrë të ardhura, ose me huapërdorje. Të disponosh pronën do të thotë që të kesh të drejtë të përcaktosh “fatin” e sendit/pasurisë. Pra nëse ju jeni pronare e një pasurie, keni të drejtë që të kryeni veprime juridike të ndryshme si shitje, shkëmbim, ta vendosni në hipotekë, madje mund të hiqni dorë nga një e drejtë që keni mbi të. Sipas nenit 1 të Kodit të Familjes të Shqipërisë, Martesa si një bashkëjetesë, mbështete në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimin reciprok, si baza e unitetit në familje. Marrëdhënia pasurore midis bashkëshortëve rregullohet me ligj në formën e bashkësisë ligjore. Por, marrëdhënia pasurore midis bashkëshortëve mund të rregullohet gjithashtu me anë të një marrëveshjeje të veçantë noteriale (kontrata martesore), ku bashkëshortët rregullojnë marrëdhënien pasurore sipas dëshirës, për aq kohë sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Familjes dhe legjislacionin përkatës. Kontrata martesore bëhet me akt noterial përpara lidhjes së martesës, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm në mënyrë që të përjashtohen nga bashkësia ligjore në momentin e

¹⁰⁰ Mecaj Vjollca, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, fq.356

lidhjes së martesës. Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore, që parashikon Kodi i Familjes. Për të shikuar në mënyrë më të hollësishme problemin e regjimit pasuror martesor në Shqipëri duhet që të kthehemi se ku është gjeneza e kësaj. Një nga momentet më të vështira pas divorci është ndarja e pasurisë. Kjo gjëndje e vështirë nuk është vetëm për ish-bashkëshortët por edhe për familjarët e tyre. Për këtë arsye, sa më të qartë të jeni në lidhje me atë ç'ka ju takon në rast divorci më shumë kokëçarje do ti kurseni vetes.

3.9 KOMPACION NË MES KODIT FAMILJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE LIGJIT TË FAMILJES MAQEDONISË

Prona e përbashkët që bashkëshortët e kanë fituar gjatë martesës në bazë të ligjit ndahet në pjesë të barabarta. Në raste të caktuara me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve, gjykata mund të caktojë shumicën e pronës për njërin nga bashkëshortët nëse vërtetohet se kontributi i tij në pronën e përbashkët është më i madh se kontributi i bashkëshortit tjetër. Gjatë divorcit si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në Shqipëri bashkëshortët mund të vendosin vetëm në ndarjen e pronës. Nëse midis tyre lind ndonjë mosmarrëveshje atëherë gjykata do të vlerësojë vetëm pjesën e secilit bashkëshortë duke përfshirë këtu edhe të ardhurat personale dhe të ardhurat e tjera të secilit bashkëshort veç e veç.

Në Republikën e Maqedonisë ish- bashkëshortët kur vin radha e regjimit pasuror ata midis tyre nënshkruajnë një marrëveshje, marrëveshja në vehte përmban disa nene. E njëjta gjë ndodh edhe në Republikën e Shqipërisë. Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës. Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre. Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës. Noteri ka detyrimin të depozitojë kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës.

Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.¹⁰¹ Në Republikën e Shqipërisë, Bashkëshortët nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesa, si dhe përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të administrimit ligjor dhe të kujdestarisë. Secili nga bashkëshortët mund t'i japë të drejtën bashkëshortit tjetër për ta përfaqësuar gjatë regjimit pasuror martesor, sipas dispozitave të Kodit Civil. Mandati i përfaqësimit mund të revokohet në çdo kohë. Bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor vetëm pas kalimit të 2 vjetëve të zbatimit të tij.¹⁰²

Ndryshimet, në këtë rast, duhet të bëhen në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën fillestare të martesës. Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashigimisë. Pronësia krijon të drejta dhe detyrime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë. Askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveçse kur kemi të bëjmë me interesin publik të caktuar me ligj. Në rast të eksproprijimit të pronësisë ose në rast të kufizimit të pronësisë garantohet kompensimi i drejtë i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut.¹⁰³ Po ashtu të drejtat pasurore i mbështet edhe ligji për trashigimi¹⁰⁴ dhe ligji për të drejta pronësore¹⁰⁵ dhe sendore.

¹⁰¹ Neni 70, *Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë*, dispozita të përgjithshme.

¹⁰² Neni 71, *Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë*, Dispozita të përgjithshme.

¹⁰³ Neni 30, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*

¹⁰⁴ *Ligji për pronësi dhe të drejta sendore*, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.18/2001

¹⁰⁵ *Ligji për pronësi dhe të drejta sendore*, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.18/2001

3.10 REGJIMI PASUROR MARTESOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kusht për ekzistimin e pasurisë së përbashkët është ekzistimi i martesës jo vetëm formalisht por edhe realisht. Pa ekzistimin e bashkësisë martesore nuk mund të flitet për ekzistimin e pasurisë së përbashkët, sepse asaj do ti mungonte baza juridike mbi të cilën lind pasuria e përbashkët. Pasuria që bashkëshortët e fitojnë gjatë kohës sa zgjatë ndërprerja e jetës së përbashkët bashkëshortore nuk është pasuri e përbashkët e tyre, por pasuri e veçantë, pavarësisht që martesa ende nuk ka pushuar.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të krijohet në dy mënyra:

- ✓ *Punë të drejtpërdrejtë dhe*
- ✓ *Punë të tërthortë.¹⁰⁶*

Mënyra e drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur bashkëshorti martesor kryen veprimtari e cila drejtpërsëdrejti sjell të ardhura, qoftë në të holla apo në natyrë. Ndërsa mënyra e tërthortë dallon nga ajo e drejtpërdrejtë sepse bashkëshorti martesor kryen veprimtari të tjera si: punët shtëpiake, kujdesi për fëmijët etj. Të cilat nuk sjellin të ardhura, mirëpo e ndihmon bashkëshortin tjetër dhe në mënyrë të tërthortë i kontribuon realizimit të të ardhurave. Puna e bashkëshortëve martesorë paraqet kusht tjetër për ekzistimin e pasurisë së përbashkët. Puna duhet të kuptohet si aktivitet dhe kontribut për plotësimin e nevojave të bashkësisë martesore dhe familjare. Puna e bashkëshortëve mund të jetë e përbashkët apo individuale.

Puna e përbashkët ekziston kur të dy bashkëshortët kanë të njëjtin profesion dhe punojnë të njëjtën punë, kurse puna individuale ekziston kur bashkëshortët nuk e kanë të njëjtën punë dhe nuk janë të profesionit të njëjtë. Objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve janë të drejtat mbi sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme, të drejtat reale si servitutet, e drejta e pengut etj. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve rregullohet me norma urdhëruese. Vlera e hiseve të titullarëve në pasurinë e përbashkët nuk dihet, por që të dy bashkëshortët së bashku janë titullar të një të drejte reale, fjala vjen të pronësisë mbi një send, por nuk dihet se mbi cilën pjesë të atij sendi është pronar secili prej tyre apo që të dy bashkëshortët janë kreditor të ndonjë të drejte

¹⁰⁶ Musli Gashi, Ilir Rashkaj, Raport nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, Justicia, *Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve*, Prishtinë, fq.70

kërkesore, p.sh. tek kontrata e shitblerjes së sendit dy bashkëshortët janë titullar të së drejtës së pasurisë së përbashkët, çmimit të shitjes së sendit, por edhe me këtë rast nuk dihet vlera e hiseve të tyre në atë çmim, sepse ajo mbetet e papërcaktuar deri sa të bëhet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët. Mosrespektimi i vlerës së hiseve të titullarëve të së drejtës së pasurisë së përbashkët është karakteristikë tjetër që pasuria e përbashkët dallon nga bashkëpronësia. Kur flitet për bashkëpronësinë, duhet thënë se dihet qartë vlera e secilës hise dhe titullari i saj. Çdo bashkëpronar ka pjesën e caktuar alikuote (1/2, 1/3, 30% etj.), ndryshe nga pronarët e përbashkët, ku hiset e tyre në të drejtën e pasurisë në sendet e njëjta nuk dihen dhe nuk janë të përcaktuara as në mënyrë ideale e as reale.¹⁰⁷

Midis këtyre dy institucioneve ekzistojnë dallime edhe sa i përket rregullave që vlejnë për regjistrimin e sendeve të paluajtshme në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme. Andaj të drejtat e bashkëshortëve mbi sendet e paluajtshme, që janë objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesëtë pacaktuara (neni 50 par.1 LFK)¹⁰⁸

„Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Në rastet kur të dy bashkëshortët janë regjistruar në regjistrin publik të paluajtshmërive si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, konsiderohet se ata në këtë mënyrë e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë. Ndërsa, të drejtat e bashkëpronarëve mbi sendet e paluajtshme, që janë objekt i bashkëpronësisë, regjistrohen në emër të secilit bashkëshortë së përbashkët”¹⁰⁹

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetesës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj. Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria etij (neni 52). LFK në nenin 53 par.1 ka paraparë se bashkëshortët, në çdokohë, mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje dhe po ashtu ka paraparë që marrëveshja duhet të bëhet me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për arritjen e marrëveshjeve të tilla. Sipas LFK-së të drejtë të

¹⁰⁷ Musli Gashi, Ilir Rashkaj, Raport nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, Justicia, *Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve*, Prishtinë, fq.70

¹⁰⁸ Neni 50 par.1 LFK

¹⁰⁹ Neni 50 par.1 LFK

kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur i vdekur dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesën e vet nuk mund ta realizojë nga pasuria e veçantë e atij bashkëshorti. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në të shumtën e rasteve bëhet me marrëveshje. Mirëpo në rastet kur janë kontestuese hiset e bashkëshortëve ose kur të drejtat dhe sendet e caktuara nuk dihet nëse bëjnë pjesë në objektin e pasurisë së përbashkët, atëherë gjykata vendos në procedurë civile (kontestimore) pranë gjykatës kompetente (komunale). Ndërsa kur këto çështje nuk janë kontestuese midis bashkëshortëve, pjesëtimin e pasurisë gjykata e bën në procedurë jashtë kontestimore. (Nga momenti i pjesëtimit të pasurisë së përbashkët hiseja që i përket çdo bashkëshorti është pronësi e veçantë). Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si: kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët (neni 54par.1 i LFK). Pjesëtimi konkret bëhet duke caktuar se cilat janë sendet që shërbejnë ekskluzivisht për përdorim personal të bashkëshortëve dhe sendet që shërbejnë për kryerjen e zejes a të profesionit. Me kërkesën e bashkëshortit nga masa pasurore do të veçohen sendet që shërbejnë ekskluzivisht për përdorim personal të bashkëshortit dhe do të dorëzohen atij për përdorim të mëtejshëm.¹¹⁰

Në Republikën e Kosovës regjimi i pasurisë së përbashkët rregullohet edhe nëpërmjet Ligjit për Trashigimi. Sipas ligji për trashigimi (neni 26) bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi dhe bashkëshorti i tij kanë pasur pasuri të përbashkët sipas regjimit të tyre të pasurisë bashkëshortore, vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit pas ndarjes së pasurisë së përbashkët bëhet objekt i trashëgimisë.

¹¹⁰ Oruqi Gani, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2008, fq.125

Asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet në frymën e kufizimit të së drejtës së bashkëshortit pasjetues për çka do që atij i takon sipas dispozitave të Ligjit të Familjes në lidhje me mbarimin e regjimit të pasurisë bashkëshortore.¹¹¹

Martesa ka impaktin e vet pasuror e financiar. Ka një tërësi rregullash në Kodin e Familjes që i dedikohen pikërisht marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Këto rregulla përbëjnë atë që KF e përfshin në “*regjimet pasurore martesore*”. Këto rregulla i japin përgjigje një sërë pyetjesh mbi paqartësitë që mund të kemi lidhur me pasuri të caktuara, të krijuara para, gjatë ose pas martesës ose pasuri të fituara bashkërisht ose individualisht, të dhuruara ose të trashëguara, të luajshme ose të paluajshme, etj. Çasti/koha e lidhjes së martesës ka ndikim në kategorizimin e pasurisë në pasuri para martesore ose post martesore. Nga ana tjetër, regjimi pasuror, i cili mund të jetë me ligj ose me kontratë ndikon në kategorizimin e pasurive si vetjake apo të përbashkëta. Dispozitat e Kodit të Familjes parashikojnë se, në regjimin e bashkësisë ligjore çdo pasuri e fituar. Gjatë martesës qoftë nga njëri bashkëshort apo nga të dy bashkëshortët është pjesë e bashkësisë ligjore. Pasuria e bashkëshortëve prezumohet e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak (shih më poshtë, pika 11).

Rritja e fëmijëve, kujdesi për ta dhe për familjen është një punë shumë e dobishme dhe rrit cilësinë e jetës familjare. Duke punuar në këtë mënyrë, keni kontribuar për mbarëvajtjen dhe shtimin e pasurisë në bashkësinë ligjore. Nëse martesa zgjidhet, do të pjesëtoni me bashkëshortin tuaj pasuritë që keni fituar gjatë martesës. Për këtë, nuk ka rëndësi nëse keni marrë pagë apo jo. Kontributi juaj brenda familjes do të mbahet parasysh nga gjykata gjatë pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore. Siç e kemi shikuar deri më tani bashkësia martesore ka lidhur shumë dilema për pozitën juridike të regjimit pasuror martesor. Kuptuam se regjimi pasuror martesor është një tërësi e normave juridike më të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore që krijohen në mes të çifteve. Pasi kemi shikuar regjimet pasurore martesore vërejtëm se ekzistojnë dy lloje prej tyre. Regjimi ligjor dhe ai i kontraktuar. Gjermania, Austria, Franca, Zvicër si vende kanë përcaktuar regjimin pasuror kontraktuar midis bashkëshortëve kurse Krocacia, Sërbia, Shqipëria kanë të përcaktuar regjimin pasuror ligjor. Republika e Maqedonisë nuk ka diçka konkrete të përcaktuar për regjimin pasuror, në vendin tonë është i përcaktuar regjimi pasuror ligjor dhe ky vendi nuk u jep shumë

¹¹¹ Ligji për trashigiminë e Kosovës, Ligji, Nr.2004/26

hapsirë të madhe palës kontraktuese për vullnetin e lirë. Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë e veçant dhe e përbashkët ndërkohë mund të merremi vesht për administrimin dhe disponimin me të. Kontrata martesore është vullnetare. Duke u bazuar në regjimet pasurore martesor nuk mund të themi se njëri apo tjetri është regjim pasuror më i përshtatshëm, sepse një gjë e tillë nvalet nga pasuria dhe niveli i bashkëshortëve. Bashkësia ligjore dhe regjimi i bashkësis ligjore është avantazhi më i madh në regjimin e bashkësisë. Regjimi vlerësohet dhe dhe kontribon në të holla dhe në drejtim të kësaj natyre. Regjimi pasuror martesor në Shqipëri dhe Kosovë janë të ndara në forma dhe parashikohen në Kodin Familjar, në Republikën e Maqedonisë është vetëm e njohur legjislacioni i cili i mbron. Siç përmenda edhe më lartë Maqedonia nuk e ka shumë reale regjimin pasuror martesor, noterët thonë pikë së pari bashkëshortët shkojnë në notariat e më pas në nënshkrim martesor. Mosbindja e vlerave morale, mashtrimi dhe mosbesimi midis partnerëve të biznesit detyrojnë të gjitha qytetatrët të hyjnë nëpër kontrata të noterizuara. Noteriat në vendin tonë për herë të parë është vë në përdorim në vitin 1996. Me vendosjen e notariatit është bërë një ha shumë i madh në integrimin e vendit tonë. Jeta sociale dhe ekonomike në vendet rajonale mund të jetë një parakusht për ndryshime.

KAPITULLI I KATËRT

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Lëndë e këtij hulumtimi ishte përfshirja e kontratës martesore si akt juridik kryesisht analiza e normave juridike që rregullojnë të drejtën martesore dhe të drejtat e bashkëshortëve në të drejtën familjare të Republikës së Maqedonisë dhe krahasimi me vendet e jashtme. Përmes kontratës martesore bashkëshortët kanë mundësin të negociojnë lidhur me pozitën juridike-pasurore të tyre duke pranuar atë modalitet të regjimit të kontraktuar, që i përgjigjet specifikave të situatës reale. Nga ky hulumtim kemi kuptuar para se gjithash se kontrata martesore, ka për qëllim të fiksoje statusin financiar të ekonomisë së ardhshme të familjes, respektivisht të pozitës juridiko-pasurore të bashkëshortëve në martesë. Me anë të kontratës martesore shprehet liria e bashkëshortëve për t’iu referuar njërit nga modelet që ofron ligji në dispozicion të tyre. Në këtë studim kemi përfunduar se kontrata martesore përfaqëson veprimin juridik me anë të së cilës dy persona që do të lidhin martesë, krijojnë regjimin martesor pasuror, ndryshojnë ose shuajnë regjimin martesor pasuror që ka ekzistuar që nga lidhja e martesës.

Sipas të drejtës së përgjithshme administrimi i një pasurie, normalisht bëhet nga pronari i saj, nëse ai është i aftë të bëjë këtë. Përrjashtimisht, administrimi i një pasurie kryehet nga një përfaqësues i caktuar me marrëveshje, nga një përfaqësues ligjor ose nga një përfaqësues i caktuar nga gjykata. Përfaqësues i caktuar me marrëveshje është i detyruar të respektojë tagrat që i janë dhënë dhe është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit. Me shumë modesti dhe më shumë shpresë mund të deklaroj së jam munduar që në punimin tim të magjistraturës të paraqes disa vlera në kërkim shkencorë pra në shkencën e të drejtës civile në vendin tonë dhe në rajon. Më lartë kemi trajnuar me shumë kujdes evaluimin e martesës dhe regjimit pasuror martesor po ashtu është trajtuar edhe divorci. Regjimi pasuror i bashkëshortëve është trajtuar shumë hollësisht në disa periudha. Kemi përmendur edhe nocionet themelore të kontratës martesore. Unë ndërtimin e kësaj teme e kam filluar me prezantimin e problemit themelor pra kontratën martesore si domosdoshmëri apo realitet. Jam nisur nga shoqëria shqipëtare dhe legjislacionet që mbrojnë këtë dukuri. Më gjithë zhvillimet dhe evoluimin e regjimeve pasurore martesore ka akoma shumë për të bë në këtë fushë.

Kontrata (para) martesore është kontratë me të cilën bashkëshortët, gjegjësisht bashkëshortët e ardhshëm, në mënyrë të pavarur përcaktojnë regjimin pasuror martesor. Me lidhjen e kësaj kontrate bashkëshortët në mënyrë të pavarur dhe me marrëveshje i rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore martesore. Lidhja e kësaj kontrate, në asnjë mënyrë nuk shpreh (nuk do të duhej) mosbesimin e bashkëshortëve ndaj njëri - tjetrit porse nëpërmjet saj tentohet të eliminohen kontestet rreth asaj se "çka e kujt është". Shtrohet pyetja se kjo kontratë a i parandalon shkurorëzimet dhe a ka ndikuar paraqitja e saj në zvogëlimin e numrit të shkurorëzimeve? Lidhja e kësaj kontrate nuk e parandalon shkurorëzimin e as që do të ndikoj në zvogëlimin e numrit të shkurorëzimeve. Sipas avokates Milena Milanoviç "*martesa, si një nga institucionet më të rëndësishme të shoqërisë, është duke u shkatërruar gjithnjë e më shumë. Nuk e dimë se çka do ta shpëtonte atë e as që do ta dimë këtë edhe për një kohë të gjatë. Është fakt i pakontestueshëm se lëvizja femine ka ndikuar pozitivisht në realizimin e të drejtave të grave, por ndoshta dhe vetëm ndoshta, kjo lëvizje ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të shkurorëzimeve, ngase tani gruaja është bërë më e vetëdijshme, ekonomikisht më e pavarur dhe më pak e gatshme për kompromise...*" përfundon kjo avokate e njohur e cila tërë karrierën e vet është marrë me probleme martesore. Si për ironi, duhet thënë se kontrata (para) martesore, në një farë mënyre e lehtëson shkurorëzimin. Megjithatë, në kontestet e kësaj natyre, nuk do të duhej të mohohej paraqitja e një faktori i cili do ta lehtësonte dhe përshpejtonte procesin gjyqësor të shkurorëzimit. Në modesti dhe me shpresën që ky punim do të sjellë sadopak vlera në kërkimin shkencor në shkencën e së drejtës civile, në Maqedoni, parashtrihen disa sugjerime të cilat finalizojnë këtë punim dhe mbartin qëllimin e tij. Sikur kemi pa që në dispozitat e Ligjit për Familje të RM-së nuk ekziston detyrim të bashkëshortëve për t'i bërë të njohur njëri-tjetrit për gjëndjen e tyre pasurore në momentin e lidhjes së kontratës martesore. Qëllimi i martesës nuk është përfitimi ekonomik nga bashkëshorti tjetër, për rrjedhojë në lidhjen e martesës duhet të jenë të parëndësishme të ardhurat ose gjendja pasurore e bashkëshortit tjetër.

Rekomandojmë që, ligji të parashikojë detyrimin e noterit për këshillimin ligjor të të dy bashkëshortëve veçmas nga njëri-tjetri, në lidhje me pasojat e kontratës martesore. Duke pasur parasysh përhapjen e pakët të kontratës martesore në praktikë, në Maqedoni rekomandojmë që, të mundësohet në kod.fam. Zgjedhja, e regjimeve pasurore me kontratë, të rregulluara në dispozitat e Ligjit për Familje nga bashkëshortët jo vetëm nëpërmjet kontratës martesore, por edhe nëpërmjet regjistrimit në aktin e martesës, nëpërmjet deklarimit të vullnetit të të dy

bashkëshortëve, në momentin e lidhjes së martesës. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, rekomandojmë regjimin e pasurive të ndara për ata bashkëshortë të cilët kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre, para lidhjes së martesës, ose kanë një disbalancë të theksuar të pasurisë, në pronësi të secilit prej tyre; ose kanë fëmijë nga martesa të mëparshme; ose ushtrojnë veprimtari tregtare, të cilat mbartin risk të lartë financiar, risk me të cilin nuk dëshirojnë të ekspozojnë pasurinë e familjes ose pasurinë e bashkëshortit tjetër. Në kuadër të kontratës martesore dhe regjimeve pasurore martesore, në Maqedoni rekomandohet të kryhen studime ligjore, konferenca dhe trajnime të gjyqtarëve, noterëve dhe avokatëve, me qëllim kuptimin dhe interpretimin më të mirë të dispozitave të Ligjit për Familje. Nga analiza e praktikës gjyqësore, të trajtuar në këtë punim evidentohen probleme të shumta në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Familje nga gjyqtarët dhe noterët.

4.1 Literatura e shfrytëzuar

- 1) Alishani A. Alajdin, *E drejta e detyrimeve pjesa e përgjithshme*, Prishtinë , 2002
- 2) Aliu Abdulla , *E drejta e detyrimeve* , material i autorizuar USHT, Tetovë , 2009
- 3) Aliu Abdulla, *E drejta familjare*, Prishtinë , 2007
- 4) Ana Axhievaska, *Bazat e së Drejtës Private*, për vitin e tretë, Shkup
- 5) Arta Mandro – Bilalli, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006
- 6) Bojan Pajtic, *Bracni Imovinski Ugovor*, Novi Sad, 2008
- 7) Bonilini Giovanni, *Manuali i së Drejtës Familjare*, Tiranë, 2005
- 8) Brestovci.F, *E drejta civile*, Prishtinë , 2004
- 9) Brestovci.F, *E drejta procedurale civile II*, Prishtinë, 2004
- 10) Çapo, Axhem, *Njohuri enciklopedike nga misteret e botës I*, Shtypshk. Geer, Tiranë 2006
- 11) Cassano, Giuseppe, *Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della famiglia*, në Trattati, P. Cendon, Milano: Giuffrè Editore, 2006
- 12) Curi.P, *E drejta procedurale civile dhe Notaria*, Tiranë, 2008
- 13) Gani Oruqi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2008
- 14) Gjeçovi Shtjefen, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1998
- 15) Latifi.J, *E drejta familjare në Kosovë*, Prishtinë , 2006
- 16) Mecaj Vjollca, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006
- 17) Podvorica Hamdi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2005
- 18) Scherpe, *Marital agrrements and private autonomy in Comperative Perspective*,
- 19) Sonila OMARI – *E drejta familjare*, botimet Morava, Tiranë 2012.
- 20) Triva Sinisa –Dika Mihajlo, *Izvanpariocno procesno pravo*, Zagreb.
- 21) Xhensila Kadi, *Nocioni i regjimit pasuror në marrëdhëniet bashkëshortore sipas legjislacionit shqipëtarë*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ICLS 2015 – libri i apstrakteve.
- 22) Zendeli, Emine, *Marrëdhëniet juridiko-pasurore bashkëkohorë të bashkëshortëve*, Tetovë, 2017
- 23) Zendeli, Emine *Contraction property regime of spouses-Comparative Overview*
- 24) Zhivkovska Rodna , *Опит дел на граѓанското право, Воведни теми*, Европа 92, Скопје, 2005

- 25) Zhivkovska Rodna , *Опит дел на граѓанското право, Практикум*, Европа 92, Скопје , 2005
- 26) Zhivkovska Rodna , *Стеварно право*, Европа 92, Скопје, 2005
- 27) Јаневски Арсен и Зороска- Камиловска Таќјана , *Граѓанско процесно право (Книга прва – Парнично право)* Правен факултет „Јустинијан Први“ – УКИМ, Скопје, 2009

4.2 Ligje dhe vendime

- 1) <http://en.wikipedia.org/wiki/heritage>
- 2) http://gencxerxa.page.tl/Kanuni--k1-Lek%EB-Dukagjini-k2-_Fejesa,-martesa,-sheji,-m%EBsitnia.htm
- 3) http://jus.igjk.rksgov.net/676/1/Pasuria%20e%20p%C3%ABrbashk%C3%ABt%20e%20bashk%C3%ABshrt%C3%ABve_Shqip.pdf
- 4) Kodi i Familjes Ligji Nr.9062, date 08.05.2003
- 5) <http://pravo.org.mk>
- 6) *Ligji për plotësim e Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore*, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 18/2001) titulli para nenit 243 dhe neni 243
- 7) Raport, Aurela Anastas, *Të drejtat e gruas në legjislacioni shqiptëtar*, Tiranë, 2013
- 8) *Ligji për Familje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.153 nga 20.10.2014
- 9) Mr.Sc Afrim Shala, Mr.sc Albert Zogaj, *Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsim Ligjor*, Justica, Viti I/2009. Numri 1/2009, fq.105
- 10) <https://studioligjore.wordpress.com/2012/04/20/pasuria-mes-bashkeshorteve-sipas-rregjimit-te-pasuror-ne-bashkesi/>
- 11) *Kodi familjar i R.Shqipërisë* , 2007
- 12) *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, 1998
- 13) *Ligji për familje*, Gazeta Zyrtare e R.Kosovës, Ligj nr.2004/26
- 14) Vendim i GJED C-143/78, 17 Mars 1979 “*Jacques de Cavel vs Louise de Cavel*”
- 15) *Zakon za vonparecna postapka* , sluzhben vesnik na R.M , br.19/1979

